



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 67 Akti

Nr. 113 Vendimi
Tiranë, më 08.03.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda	Çiftja	Kryesuese
Roland	Ilia	Anëtar
Firdes	Shuli	Relatore

me sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, më datë 06.03.2019, ora 10:00 dhe datë 08.03.2019, ora 10:00 në Pallatin e Koncerteve, kati i dytë, salla 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arqilea Koça, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 179/b, A, Ç, D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;**

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatimin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin Arqilea Koça, proces i cili ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tri kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, dhe në përfundim, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Arqilea Koça, është subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji nr. 84/2016”), të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Arqilea Koça, ushtron funksionin e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme që nga viti 1993. Si i tillë, në bazë të nenit 4, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar në shortin e datës 15.01.2018.

3. Me shkresën nr. *** prot., datë 20.11.2017, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. *** prot., datë 24.11. 2017 (16 fletë), Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, (në vijim “ILDKPKI”) ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Arqilea Koça (16 fletë), si dhe 1 (një) dosje me nr. IND ***.

4. Me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. *** prot., datë 15.11.2017, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, (në vijim “DSIK”), ka vënë në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Arqilea Koça (12 fletë).

5. Me shkresën nr. *** prot., datë 24.04.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. *** prot., datë 24.04. 2018, Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, ka vënë në dispozicion raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Arqilea Koça (32 fletë).

6. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka zhvilluar shortin në datën 15.01.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arqilea Koça, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Roland Ilia dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

7. Me fillimin e procesit të rivlerësimit, trupi gjykues, administroi:

(i) Aktin për vlerësimin e pasurisë, sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga ILDKPKI-ja.

(ii) Raportin e vlerësimit të figurës, sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga DSIK-ja.

(iii) Raportin e vlerësimit profesional, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

8. Me vendimin nr. 1, datë 24.01.2018, trupi gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit z. Arqilea Koça, duke përfshirë të tri kriteret, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Etleda Çiftja. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

9. Me vendimin nr. 2, datë 14. 02.2019, trupi gjykues vendosi:

(i) Të përfundojë hetimin paraprak në lidhje me verifikimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Arqilea Koça;

(ii) Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar atij barrën e provës mbi rezultatet paraprake të hetimit kryesisht, për të paraqitur prova e shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, sipas parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016;

(iii) Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47, të Kodit të Procedurave Administrative; dhe

(iv) Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi deklarin e konfliktit të interesit, të drejtën për t'u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarëve, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta. Subjekti i rivlerësimit, nuk ka deklaruar konflikt interesi.

10. Më datë 28.02.2019, në rrugë elektronike, vuri në dispozicion të Komisionit parashtresë me pretendimet e tij dhe dokumente shkresore bashkëngjitur.

11. Me vendimin nr. 3, datë 03.04.2019, trupi gjykues, vendosi të ftoj subjektin e rivlerësimit, z. Arqilea Koça, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 13.12.2018, ora 13:00, paradite, pranë Pallatit të Koncerteve, kati i 2-të, salla 0, Tiranë.

12. Më datë 06.03.2019, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Arqilea Koça, sipas nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit, dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*, trupi gjykues, vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Arqilea Koça, bazuar në të tri komponentët: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

II.1. VLERËSIMI I PASURISË

II.1.a Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI

Nga aktet e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private nga viti 2004 (për vitin 2003) deri në vitin 2017 (për vitin 2016). Më datë 20.01.2017, sipas ligjit nr. 84/2016, subjekti ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

Ky institucion ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe me aktin nr. *** prot., datë 20.11.2017, ka konkluduar se:

- *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

II.1.b. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017^[1] dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, z. Arqile Koca, është kryer një proces i plotë hetimi administrativ, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar pranë Komisionit, çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, si dhe komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të këtij ligji dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në:

[1] “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “proces i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

- a) Verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur;
- b) Verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë;
- c) Evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive;
- ç) Evidentimin e deklarimeve të rreme;
- d) Nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit; dhe

me qëllim verifikimin nëse subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Hetimi administrativ nga ana e Komisionit, sipas neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84 /2016, është kryer në lidhje me pasuritë si vijojnë:

Pasuri të përfituara nga shoqëria “**” sh.p.k., si vijojnë:**

1. Garazh i ndodhur në katin e *** nën tokë (***), shkalla nr. ***, ***, Tiranë, me sipërfaqe parkimi 33.2 m² dhe me sipërfaqe të përbashkët 22 m². Në total sipërfaqja 55.2 m², përfituar me kontratë këmbimi me shoqërinë “****” sh.p.k.¹ Subjekti i rivlerësimit zotëron pronën në bashkëpronësi (50 %) me bashkëshorten.

2. Garazh i ndodhur në katin e *** nën tokë (***), shkalla nr. ***, ***, Tiranë, me sipërfaqe parkimi 60.6 m² dhe me sipërfaqe të përbashkët 46.7 m². Në total sipërfaqja 107.3 m², përfituar me kontratë shkëmbimi me shoqërinë “****” sh.p.k.² Subjekti i rivlerësimit zotëron pronën në bashkëpronësi (50 %) me bashkëshorten.

3. Njësi e ndodhur në katin ***, shkalla ***, ***, Tiranë, me sipërfaqe 101 m², dhe me sipërfaqe të përbashkët 7.3 m². Në total sipërfaqja 108.3, përfituar me kontratë shkëmbimi me shoqërinë “****” sh.p.k.³. Subjekti i rivlerësimit zotëron pronën në bashkëpronësi (50 %) me bashkëshorten.

4. Apartament nr. ***, në katin e ***, shkalla nr. ***, në ***, Tiranë, me sipërfaqe ndërtimi 137.8 m², me sipërfaqe të përbashkët 16.6 m² dhe me sipërfaqe verande 24.7 m². Në total 179.1 m², përfituar me kontratë këmbimi⁴. Subjekti i rivlerësimit zotëron pronën në bashkëpronësi (50 %) me bashkëshorten.

¹ Shih kontratë shkëmbimi në dosjen e Komisionit, nr. *** kol, datë 02.12.2014, faqe 4, pika 1.

² Shih kontratë shkëmbimi në dosjen e Komisionit, nr. *** kol, datë 02.12.2014, faqe 4, pika 2.

³ Shih kontratë shkëmbimi në dosjen e Komisionit, nr. *** kol, datë 02.12.2014, faqe 4, pika 3.

⁴ Shih kontratë shkëmbimi në dosjen e Komisionit, nr. *** kol, datë 02.12.2014, faqe 5, pika 8.

5. Apartament nr. ***, në katin e ***, shkalla nr. ***, në ***, Tiranë, me sipërfaqe ndërtimi 110 m², me sipërfaqe të përbashkët 10.3 m². Në total 120 m², përfitur me kontratë shkëmbimi⁵. Subjekti i rivlerësimit zotëron pronën në bashkëpronësi (50 %) me bashkëshorten.

Nga hetimi paraprak, rezultoi se:

- ZRVPP-ja Tiranë⁶ konfirmoi se në emër të z. Arqilea P. Koça, figurojnë të regjistruara pasuritë e deklaruara si më sipër me këto nr. pronësie ***, ***, ***, ***, ***. Subjekti ka pasur në pronësi dhe katër pasuri të tjera të përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k., të shitura përkatësisht në vitet 2009, 2010, 2015 dhe 2018⁷, konkretisht pasuritë me numra ***, ***, ***, dhe ****⁸.

- OSHEE-ja⁹ konfirmon se data e hapjes së 8 kontratave për energjinë elektrike në emër të subjektit është 25.03.2009, ndërkohë që pagesat për energjinë elektrike, kanë filluar të paguhen për periudhën tetor 2010 deri në tetor 2018 (kur është dërguar informacioni).

- Subjekti i ka marrë në dorëzim pasuritë duke u bërë posedues i të drejtave reale mbi to, që prej vitit 2009, vërtetuar me deklaratimet e tij¹⁰ “... për secilën nga pasuritë, pjesë e kontratës së shkëmbimit, kam marrë çelësat në vitin 2009, pasi regjistrimi i tyre është bërë në vitin 2014...” dhe me informacionin historik për shpenzimet e energjise elektrike, marrë nga OSHEE-ja.

- Këto pasuri janë deklaruar në daklaratën periodike për vitin 2014, kur është bërë kalimi i pronësisë në emër të subjektit dhe regjistrimi i tyre në ZVRPP-në Tiranë, si dhe në deklaratën për “Vetting”.

- Këto pasuri nuk janë deklaruar në deklaratimet periodike për vitet 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, në kundërshtim me nenin nr. 4/1/a, të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, duke e bërë këtë deklaram të pasaktë. Por, në deklaratën periodike për vitet 2009 dhe 2010, janë deklaruar të ardhura nga shitja e dy prej pasurive.

Lidhur me pretendimin e subjektit se nuk i ka deklaruar pasuritë për shkak se nuk ka qenë *de jure* pronar i tyre, Komisioni, vlerëson se ky pretendim bie në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, i cili parashikon se: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të të njëjtit ligj detyrohen të deklarojnë pranë ILDKPKI-së, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të

⁵ Shih kontratë shkëmbimi në dosjen e Komisionit, nr. ***kol, datë 02.12.2014, faqe 4, pika 5.

⁶ Shih shkresën e ZVRPP-së Tiranë me nr. ***prot., datë 12.02.2018, pika 6.

⁷ Shih kontratat me numra nr. ***, datë 13.03.2009, nr. ***, datë 04.03.2010, ***, datë 11.09.2015 dhe nr. ***, datë 13.06.2018.

⁸ Shih dokumentet bashkëngjitur me shkresën nr. *** prot., datë 12.02.2018, të ZVRPP-së Tiranë.

⁹ Shih shkresën nr. ***prot., datë 04.12.2018, të OSHEE-së.

¹⁰ Shih përgjigjet e pyetësorin të datës 6 nëntor 2018 dërguar në datë 12 nëntor 2018 në dosjen e Komisionit.

vitit paraardhës të interesave private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre si dhe detyrimet financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to...”.

Deklarimi i të ardhurave nga shitja e dy prej pasurive, si dhe pretendimi i subjektit se shkak i mosdeklarimit ka qenë se ai nuk ishte pronar *de jure* i pasurive, nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia, për mosdeklarimin e tyre në deklaratat periodike 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013.

Deklarimi dhe përfitimi i të ardhurave nga shitja e dy prej pasurive, por edhe dhënia e katër prej tyre në huapërdorje, vërtetuar gjatë hetimit administrativ, janë fakte që tregojnë se subjekti nuk ka qenë thjesht posedues i tyre, por ka ushtruar të drejta reale të pronësisë, sipas dispozitave të Kodit Civil, duke u sjellë si pronar ligjor i tyre .

Pavarësisht se mosdeklarimi i të drejtave reale mbi 8 pasuri të paluajtshme, i përket deklaratave periodike për vitet 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, Komisioni vlerëson se, si Kushtetuta në nenin Ç, pika 4 dhe nenin D të Aneksit të saj, ashtu dhe ligji nr. 84/2016, në nenet 30, 32 dhe 33 të tij, kanë parashikuar shtrirjen e procesit të rivlerësimit edhe në shqyrtimin e deklarimeve periodike të pasurisë, të kryera në të shkuarën nga subjektet e rivlerësimit, me qëllim që të identifikohen subjektet që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Neni 32, pika 5, i ligjit nr. 84/2016 parashikon: *“Deklarimet e interesave private dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit”*. Duke qenë se përcaktimet kushtetuese dhe ligjore të sipërcituara u kanë dhënë deklarimeve periodike të pasurisë vlerën e provës¹¹, ato mund të konsiderohen të së njëjtës rëndësi me deklaratën “Vetting”.

Lidhur me peshën specifike të mosdeklarimit të të drejtave reale të pronësisë, Komisioni, çmon se ligji ka parashikuar si detyrim ligjor edhe deklarimin e posedimit real të pasurive, me qëllim evidentimin e pasojave që mund të vijnë nga posedimi real i tyre, siç janë përfitimi i të ardhurave nga shitja apo përdorimi i pasurive nga persona të tretë, siç në rastin konkret ka ndodhur me subjektin e rivlerësimit. Sipas parashikimit të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekt i vlerësimit të pasurisë, është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, elemente këto të cilat rezultojnë edhe nga deklaratat periodike. Mosdeklarimi i posedimit/përdorimit real të tetë pasurive në deklaratën periodike për vitin 2009 nga ana e subjektit Koça, ka vështirësuar kontrollin e pasurive sipas parashikimit të kësaj dispozite ligjore, konkretisht: evidentimin e faktit se si dhe nga kush janë përdorur këto pasuri për disa vite, si dhe nëse janë përfituar të ardhura nga dhënia e tyre personave të tretë.

¹¹ Shih paragrafin 42 të vendimit nr. 9, datë 24.10.2018, dhe paragrafet 45/1 dhe 2 të vendimit nr. 2 date 04.02.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Për të gjitha sa është arsyetuar më sipër, Komisioni, vlerëson se mosdeklarimi i të drejtave reale të pronësisë në deklarin periodik për vitin 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, për tetë pasuritë e përfituara nga shoqëria “**” sh.p.k, është pasaktësi me pasojë deklarim të pamjaftueshem të pasurive nga ana e subjektit, dhe duhet të merret në konsideratë, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, si provë me te njëjtën rëndësi sa dhe deklaratimet e pasakta e të pamjaftueshme në deklaratën Vetting.**

Lidhur me origjinën e krijimit të këtyre 5 pasurive.

Gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

-ZVRPP-ja Tiranë¹², me kartelën e pasurisë, datë 04.05.2000, si dhe certifikatën e pronësisë, lëshuar në datë 04.05.2000, ka konfirmuar pasurinë nr. *** të llojit tokë ARË, në emër të shtetasit F. A. Gjatë hetimit nuk u vërtetua që subjekti të ketë qenë në konflikt interes me shtetasin F. A. dhe familjarë të tij.¹³

- ZVRPP-ja Tiranë, ka vënë në dispozicion dy AMTP në emër të shtetasit F. A.¹⁴: AMTP-ja nr. *** akti, datë 20.04.1999, për një sip. 880 m², dhe AMTP-ja nr. *** akti, datë 01.08.1992, për sip. 3910 m².

- Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 04.05.2000¹⁵, subjekti ka blerë nga z. F. A. dhe familjarë të tij, pasurinë me nr. ***, me sip. 830 m², në çmimin e shitjes në vlerën 415.000 lekë, të cilën e ka regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, nga ku është pajisur me certifikatë pronësie të datës 10.05.2000.

- Me kontratën e shkëmbimit të pasurisë nr. ***, datë 16.09.2005¹⁶, subjekti Arqilea Koça, në cilësinë e pronarit të sipërfaqes prej 830 m², ka shkëmbyer pronësinë e pasurisë truall me sip. 830 m², me shoqërinë “****” sh.p.k., me kusht që pala ndërtuese t’i kalojë atij në pronësi 26 % të sipërfaqes së ndërtimit mbi këtë pasuri. Me shoqërinë “****” sh.p.k., administratorin dhe ortakët e saj, nuk u vërtetua që subjekti të jetë në konflikt interesi¹⁷.

Për të verifikuar raportin e përfitimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit në këmbim të truallit të dhënë për ndërtim, krahasimisht me pronarët e tjerë të truallit në të njëjtën godinë, i është kërkuar

¹² Shih shkresën e ZVRPP-së Tiranë, nr. ***prot., datë 26.11.2018, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit.

¹³ Shih shkresën nr. ***prot., datë 08.11.2018, të Prokurorisë së Përgjithshme, në dosjen e Komisionit.

¹⁴ Shih shkresën nr. *** prot., datë 25.01.2019, të ZVRPP-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Shih në dosjen e ILDKPKI-së dhe në dosjen e Komisionit, bashkangjitur vërtetimit të ZVRPP-së Tiranë me nr. *** prot., datë 12.02.2018.

¹⁶ Shih dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁷ Shih shkresën nr. ***prot., datë 08.11.2018, të Prokurorisë së Përgjithshme Përgjithshme, në dosjen e Komisionit.

informacion shoqërisë “****” sh.p.k. Nga informacioni i vënë në dispozicion prej saj¹⁸ nuk rezultoi që subjekti të jetë trajtuar në mënyrë preferenciale nga ana e kësaj shoqërie.

Veç sa me sipër, është vërtetuar me dokumenta shkresore legjitimimi i shoqërisë “****” sh.p.k., për ndërtimin e objektit shumëkatësh, ku ndodhen tetë pasuritë e përfituara nga subjekti dhe pasuri të përfituara nga shtetasit B., T. dhe E. H., L. H., I. A.¹⁹.

Pasi u konstatua se leja e ndërtimit është dhënë nga Komuna ***, dhe ka pasur të dhëna se kryetari i kësaj Komune, zoti B. K, ka qenë në konflikte gjyqësore, pas kërimit, nuk rezultoi që subjekti të ketë pasur për shqyrtim çështje që i përkasin këtij shtetasi si dhe Komunës ***.²⁰

- Me aneks kontratë sipërmarrje, nr. ***, datë 20.06.2007²¹, është përcaktuar që subjekti dhe bashkëshortja e tij të përfitojnë sipërfaqet ndërtimore të ndara si më poshtë: sipërfaqe banimi 657.7 m², sipërfaqe dyqanesh 108.3 m² dhe sipërfaqe për garazhe 162 m².

- Me akt shkëmbimi të pasurive të paluajtshme nr. ***, datë 02.12.2014²², janë përcaktuar tetë pasuri të paluajtshme të përfituara nga subjekti i rivlerësimit.

- Në vitin 2014 është bërë regjistrimi i tetë pasurive në ZVRPP-në Tiranë²³.

Duke qenë se sipërfaqja 830 m², tokë ARË, ish pronësi e shtetasit F. A., ka shërbyer si burim për krijimin e tetë pasurive të paluajtshme nga ana e subjektit, Komisioni, ka kryer disa veprime verifikuese lidhur me ligjshmërinë e përfitimit të kësaj pasurie, në respektim të kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Lidhur me këtë, nga hetimi administrativ është konstatuar se:

(i) Në vitin 1996, midis subjektit dhe shtetasit F. A., ka pasur (sipas tyre) një marrëveshje verbale për shitjen e sip. 830 m², në ***, Tiranë, çmimi i blerjes së të cilës, është paguar me këste dhe pa dokument shkresor nga subjekti i rivlerësimit, deri në vitin 2000, kur marrëveshja verbale është finalizuar me kontratën noteriale të shitjes së pasurisë nr. ***, datë 04.05.2000. Sipas pretendimeve të subjektit dhe dëshmitarit F. A.²⁴, shkak i marrëveshjes verbale, ka qenë fakti se pasuria ka qenë e paregjistruar në ZVRPP-në Tiranë.

¹⁸ Shih shkresën nr. ***prot., datë 13.11.2018, të shoqërisë “****” sh.p.k., në dosjen e Komisionit.

¹⁹ Shih shkresën e “****” sh.p.k. nr. *** prot., datë 05.03.2018, dhe dokumentet bashkangjitur në dosjen e Komisionit.

²⁰ Shih shkresën nr. *** prot., datë 08.02.2019, në dosjen e Komisionit.

²¹ Shih dosjen e ILDKPKI-së.

²² Shih në dosjen e ILDKPKI-së dhe në dosjen e Komisionit, bashkangjitur vërtetimit të ZVRPP-së Tiranë me nr. *** prot., datë 12.02.2018.

²³ Shih shkresën nr. *** prot., datë 12.02.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁴ Në procesverbalin, datë 07.02.2019, akt i administruar në dosjen e Komisionit.

(ii) Shtetasi F. A., rezulton të jetë pasjitur me 2 AMTP:

- AMTP-ja nr. *** akti, datë 20.04.1999 për një sip. 880 m²;
- AMTP-ja nr. *** akti, datë 1.08.1992, për sip. 3910 m².²⁵

(iii) Pas kalimit të barrës së provës, me qëllim vërtetimin faktit se sip. 830 m², ka qenë përfutuar nga shtetasi F. A. me AMTP sipas ligjit nr. 7501/1991 në vitin 1996 (kohë kur u krye marrëveshja verbale midis palëve), subjekti vuri në dispozicion të Komisionit AMTP-në nr. *** akti, datë 01.08.1992, për sip. 3910 m², duke pretenduar se sip. 830 m² që ai ka blerë, i përket kësaj AMTP-je, dhe jo asaj të lëshuar në vitin 1999.

Arsyetim ligjor :

Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, parashikon kalimin në pronësi të anëtarët e kooperativës bujqësore, pjesë e përbërjes familjare në datën 01.08.1991, dhe procedurat ligjore konkrete.

Sipas pikës 5, të VKM-së nr. 230, datë 22.07.1991, “Për krijimin e Komisioneve të Tokës”, Komisioni, përcakton në bashkëpunim me fshatarët, vendin dhe sipërfaqen e tokës së secilit, dhe përpilon në dy kopje aktin e marrjes së tokës nga çdo familje, me firmë të kryetarit të Komisionit, dhe të specialistit të autorizuar nga komisioni i rrethit, si dhe të kryefamiljarit që merr tokën.

Sipas pikës 4, të Udhëzimit nr. 2, datë 02.08.1991, “Për funksionimin e Komisioneve të tokës të Rretheve të Fshatrave”, Komisioni i tokës në fshat, në bazë të të dhënave për tokën dhe përbërjes familjare, cakton sipërfaqen e tokës në m² për frymë dhe sipërfaqen e tokës për çdo familje, sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Sipas pikës 12, të po këtij udhëzimi, shtetasit i dorëzohet akti i marrjes së tokës, një kopje e të cilit i dërgohet zyrës së kadastrës.

Sipas pikës 2, të VKM-së nr. 255, datë 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, në të gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje, sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991.

Në interpretim të dispozitave të mësipërme, ish-anëtarët e kooperativave bujqësore, pjesë përbërëse e gjendjes familjare të vitit 1991, përfitonin tokë bujqësore, për të cilën pajiseshin vetëm me një akt të marrjes së tokës në pronësi.

Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se shtetasi F. A. si ish-anëtar i kooperativës bujqësore, ka përfutuar tokë bujqësore (i) në dy periudha të ndryshme, (ii) me dy

²⁵ Shih shkresën nr. *** prot., datë 25.01.2019 të ZVRPP-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

AMTP të ndryshme, (iii) në mënyrë të pakuptueshme dhe në kundërshtim me këto dispozita ligjore, duke e bërë të pabesueshëm origjinën e përfitimit të sipërfaqes prej 830 m². Veç kësaj, bindjen e Komisionit për të arritur në këtë vlerësim, e përforcojnë faktet si vijojnë:

- Të dyja AMTP-të të lëshuara përkatësisht në datat 01.08.1992 dhe 20.04.1999, edhe pse janë lëshuar në data të ndryshme, kanë të njëjtin numër akti ***.
- AMPT-ja e lëshuar, më datë 01.08.1992, ku sipas pretendimeve të subjektit, ndodhet sipërfaqja prej 830 m², është dukshëm e korigjuar në disa nga të dhënat që përmban pasi: (i) është fshirë më parë një emër pronari në krye të aktit dhe në fund të tij, dhe mbi fshirjet, është shënuar me shkrim të ndryshëm emri F. (A.); (ii) atësia e pronarit të tokës, është e ndryshme me atë të aktit të datës 20.04.1999; (iii) vërehen korigjime të dukshme në sipërfaqet e përfituara dhe në emrin e kufitarit H. A.; (iiii) nënshkrimet e pronarit F. A., janë dukshëm të ndryshme nga njëra AMTP në tjetrën.
- AMPT-ja e datës 20.04.1999, ka pasur nr. *** akti, mbi të cilën është hequr një vijë, dhe përbri është shënuar numri ***.

Në përfundim, bazuar në provat dhe faktet si më sipër, Komisioni, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë tokë ARË me sipërfaqe 830 m², e cila ka shërbyer si origjinë për përfitimin e tetë pasurive të paluajtshme nga shoqëria “**” sh.p.k.**

Lidhur me përdorimin e pasurive të përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k. :

Gjatë periudhës së rivlerësimit, me shpjegimet e subjektit²⁶ dhe sipas informacionit të OSHEE-së²⁷, rezultoi e provuar se subjekti ka dhënë në huapërdorje disa nga pasuritë e përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k., si vijon :

- Pasuria nr. ***, njësi me sip. 101 m², me nr. *** kontrate të energjisë elektrike, aktualisht në pronësi të subjektit, i është dhënë në përdorim pa shpërblim dhe pa kontratë huapërdorje shtetasit L. D., për periudhën nëntor, dhjetor 2015 dhe janar 2016. Për këtë huadhënie, subjekti pretendoi : *“...se ky shtetas e ka përdorur këtë ambient si periudhë prove për të ushtruar një aktivitet privat.Duke qenë se aktiviteti nuk pati sukses, ai u mbyll. Për tre muajt e përdorimit personi i mësipërm ka paguar faturat në emrin tim...”*

²⁶ Shih përgjigjet e pyetësorit të datës 6 nëntor 2018 dërguar në datë 12 nëntor 2018 në dosjen e Komisionit dhe përgjigjen e pyetësorit të datës 23.10.2018 në dosjen e Komisionit

²⁷ Shih shkresën nr. ***prot., datë 04.12.2018 të OSHEE-së.

Nga ekstrakti i QKB-së²⁸ dhe verifikimi *online*, rezultoi se shtetasi L. D. është regjistruar si person fizik, më datë 03.09.2015. Nga OSHEE-ja, rezulton se për muajin nëntor 2015, kjo njësi ka pasur 3006,40 lekë shpenzime; për muajin dhjetor 2015 ka pasur 6.114.40 lekë dhe për muajin janar 2016, shpenzimet janë në shumën prej 9.424 lekësh. Për muajt e tjerë, shpenzimet kanë qenë *aforfe*, çka përpunet me deklaratimet e subjektit, se ky ambient është përdorur për një periudhë të shkurtër nga ana e shtetasit L. D.

- Pasuria nr. ***, garazh me sip. 60.6 m², me nr. ***, kontratë të energjisë elektrike, aktualisht në pronësi të subjektit, për të cilin nuk kanë rezultuar shpenzime të energjisë elektrike për shkak të përdorimit si garazh, i është dhënë në huapërdorje si vendparkim (1/3 pjesë e sipërfaqes totale, pra 20 m²) shtetasit R. S., që nga muaji prill 2014, pa shpërblim, pasi ai sipas subjektit²⁹ *“...merrte përsipër të mirëmbante ambientet e garazheve të mia dhe të më ndihmonte në administrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive të mia në atë pallat si dhe ambientet e përbashkëta, pasi bënte dhe detyrën e administratorit...”* Subjekti ka vënë në dispozicion aktmarrëveshjen midis palëve nr. ***, datë 25.04.2017 (të redaktuar pas deklaratës “Vetting”), si dhe dokumente të tjera për të vërtetuar pretendimet e tij³⁰. Me këtë shtetas nuk u vërtetua që subjekti të ketë pasur konflikt interesi.³¹

Nga përmbajtja e aktmarrëveshjes me shtetasin R. S., nr. ***, datë 25.04.2017, rezulton se ky shtetas, e ka përdorur këtë garazh në huapërdorje pa kundërshpërblim që nga prilli i vitit 2014 e në vijim, me qëllim administrimin e pasurive të subjektit. Ndërkohë, është vërtetuar se subjekti ka filluar të banojë në pallatin ku ndodhet garazhi, në adresën ***, Tiranë, (në apartamentin me sip. 137.8 m², pasuria nr. ***) që prej vitit 2015³², vit nga i cili ai mund t’i administronte vetë pasuritë e tij.

Nisur nga faktet sa më sipër, është e paqartë se përse subjekti ka vijuar t’ia lejë në përdorim pa shpërblim garazhin shtetasit R. S., pas vitit 2015, në kushtet kur ai vetë ka pasur mundësi të administronte pasuritë e tij, nga të cilat tre apartamente tashmë i kishte shitur.

- Pasuria nr. ***, apartament me sip. 110 m², me nr. ***, kontratë të energjisë elektrike, shitur shtetas L. D. me kontratën e shitjes nr. ***, datë 13.06.2018.³³, për periudhën korrik 2013 - qershor 2015, është përdorur nga vjehrra e subjektit, znj. S. Sh., në kushtet e huapërdorjes, dhe në periudhën korrik 2015 - korrik 2018, është përdorur nga shtetasi M. G. po si huapërdorës.

²⁸ Shih ekstraktin e QKB-së, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit datë 23.10.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁹ Shih përgjigjet e pyetësorit të datës 6 nëntor 2018 dërguar në datë 12 nëntor 2018 në dosjen e Komisionit.

³⁰ Shih përgjigjet e parashtrimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, në dosjen e Komisionit.

³¹ Shih shkresën, nr. ***, datë 20.02.2019, në dosjen e Komisionit.

³² Shih përgjigjet e pyetësorit standard dërguar subjektit, më datë 31.01.2018, në dosjen e Komisionit.

³³ Certifikatë pronësie në emër të subjektit të rivlerësimit, lëshuar, më datë 16.12.2014. Kartelë pasurie që i përket pasurisë nr. ***, apartament, me sip.110 m², certifikatë familjare e subjektit të rivlerësimit, lëshuar nga Njësia Bashkiake Nr. ***, certifikatë familjare në emër të z. A. D., L. D., S. D., mandat urdhër pagesë nga “Alpha Bank”, datë 13.06.2018, certifikatë pasurie në emër të blerësit, shtetas L. D., lëshuar më datë 02.07.2018, kartelë pasurie në emër të shtetas L. D., me cilësinë e blerës së apartamentit, hartë treguese, etj.

Për vjehrrën e subjektit, znj. S. Sh., nuk ka një akt shkresor që të vërtetojë huapërdorjen, ndërsa për shtetasin M. G., është vënë në dispozicion kontratë huapërdorje, datë 18.07.2015³⁴. Me këtë shetas, nuk është vërtetuar që subjekti të ketë pasur konflikt interesi³⁵.

Në përfundim të hetimit administrativ për huadhënien e kësaj pasurie, është konstatuar se:

(i) Me kalimin e barrës së provës, subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumente shkresore që të vërtetojë se shtetasja S. Sh., ka pasur në përdorim pasuri të tjera në pronësi të saj në Tiranë në periudhën e huapërdorjes dhe ka pretenduar se ajo shkonte për të banuar sa te një fëmijë te tjetri, për shkak se ishte e ve. Ndërkohë, në periudhën korrik 2013 - qershor 2015, kohë kur shtetasja S. Sh. ka banuar në këtë apartament, subjekti nuk ka banuar në ***, Tiranë, por në banesën tjetër, atë me adresë Rr. “***”³⁶. Në këtë mënyrë, nuk rezulton i vërtetuar qëllimi i përdorimit të kësaj banese nga ana e znj. S. Sh., për të qenë pranë vajzës së saj, bashkëshortes së subjektit, sipas pretendimit të tij, **duke e bërë deklarin e subjektit të pavërtetë. Këto fakte, e bëjnë më të dyshimtë përdorimin pa shpërblim të kësaj banese nga ana e znj. S. Sh.**

(ii) Me kalimin e barrës së provës, subjekti nuk ka paraqitur prova shkresore për të vërtetuar nëse shtetasi M. G. ka pasur në pronësi pasuri të tjera të paluajtshme në Tiranë në periudhën që ai ka marrë në huapërdorje këtë pasuri. Vetëm në këtë rast, do të kishte vend për të arsyetuar në lidhje me shkaqet e pretenduara të dhënies në huapërdorje të kësaj pasurie ketij shtetasi³⁷. **Këto fakte, e bëjnë të dyshimtë përdorimin pa shpërblim të kësaj banese nga ana e z. M. G.**

- Pasuria nr. ***, apartament, me sip. 86 m², me nr. *** kontrate të energjisë elektrike, shitur shtetasit R. M., sipas kontratës së shitjes nr. ***³⁸, për periudhën shtator 2012 – dhjetor të vitit 2013, është përdorur nga nipi i subjektit shtetasi Th .Gj., dhe nga shkurti i vitit 2014 – korrik të vitit 2015, kjo pasuri i është dhënë në huapërdorje shtetasit M. G.

Për të vërtetuar dhënien e këtij apartamenti në huapërdorje, subjekti ka paraqitur:

- Deklaratë dore lëshuar nga nipi i subjektit, z. Th. Gj., më datë 11.11.2018, me të cilën vërtetohet se për periudhën shtator 2012 – dhjetor 2013, ai ka banuar në apartamentin, pronë e subjektit, gjatë periudhës që ka qenë student në Tiranë.

³⁴ Shih dokumentet bashkëngjitur në përgjigje të pyetësorit, datë 23.10.2018, në dosjen e Komisionit.

³⁵ Shih shkresën nr. *** prot., datë 08.02.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁶ Shih përgjigjet e pyetësorit standard dërguar subjektit, më datë 31.01.2018, në dosjen e Komisionit

³⁷ Shih parashtrimet pasi subjektit i ka kaluar barra e provës, në dosjen e Komisionit.

³⁸ Shih dokumentet bashkëngjitur me shkresën nr. *** prot., datë 12.02.2018, të ZVRPP-së Tiranë.

- Kontratë huapërdorje, datë 05.02.2014, ku rezulton se subjekti i rivlerësimit i ka dhënë në përdorim shtetasit M. G, apartamentin me sip. 86.6 m², ndodhur në katin e katërt, me afat të pacaktuar.

Fakti që subjekti nuk ka paraqitur prova shkresore për të vërtetuar nëse shtetasi M. G ka pasur në pronësi pasuri të tjera të paluajtshme në Tiranë në periudhën që ai ka marrë në huapërdorje këtë pasuri (arsyetuar si më sipër), **e bën të dyshimtë përdorimin pa shpërblim të kësaj banese nga ana e z. M. G.**

- Pasuria nr. ***, apartament me sip. 137.8 m², në ***, më nr. 546002, kontratë energjie elektrike, është apartamenti i banimit ku subjekti banon familjarisht që prej vitit 2015, deklaruar për deklaratën “Vetting”. Pagesat për energjinë elektrike kanë filluar nga janari 2010 dhe vijojnë deri në tetor 2018.

Nga verifikimi i informacionit të OSHEE-së, rezulton se për këtë apartament banimi, nga periudha 2010 – korrik 2013, janë paguar tarifa në shuma nga 130-340 lekë, gjë që tregon se kjo pasuri nuk është përdorur, çka përputhet me deklaratimet e subjektit. Nga periudha korrik 2013 – dhjetor 2014, ka pasur shpenzime të konsiderueshme të energjisë elektrike. Nga aktet rezulton se subjekti ka filluar ta përdorë këtë pasuri në vitin 2015³⁹ dhe vazhdon ta përdorë aktualisht.

Duke qenë se ka pasur paqartësi se nga kush është përdorur kjo banesë nga korriku 2013 – dhjetor 2014, është pyetur subjekti dhe pas kalimit të barrës së provës, ai deklaroi se, nga korrik 2013 deri në dhjetor 2014, këtë apartament ai e ka përdorur familjarisht⁴⁰ duke argumentuar shkaqet e përdorimit të këtij apartamenti (në ***) në të njëjtën periudhë, kur ai ka përdorur për banim edhe apartamentin në Rr. “****”. Nga informacioni i OSHEE-së për shpenzimet e energjisë elektrike, por dhe nga shpjegimet e subjektit, rezulton që për këtë periudhë (korrik 2013 – dhjetor 2014), **subjekti të ketë banuar njëkohësisht në dy apartamente, gjë që praktikisht është e pamundur. Këto fakte e lënë të dyshimtë përdorimin e kësaj banese nga ana e subjektit të rivlerësimit për periudhën korrik 2013 – dhjetor 2014.**

Lidhur me shpenzimet për arredimin e tetë pasurive të përfituara me këmbim nga shoqëria “****” sh.p.k, i janë kërkuar shpjegime subjektit. Nisur nga deklaratimet e tij⁴¹, informacionet e marra nga OSHEE-ja lidhur me përdorimin e pasurive sipas periudhave përkatëse të faturimeve të energjisë elektrike, por edhe nga likuiditetet në fund të çdo viti, nga analiza financiare, ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare për të justifikuar shpenzimet.

6. Apartament banimi, ndodhur në fshatin *, me sip. 162 m², blerë në vitin 2011. Burimi i krijimit në deklaratën “Vetting” si më poshtë:**

³⁹ Shih përgjigjet e pyetësorit standard në dosjen e Komisionit.

⁴⁰ Shih deklaratimet në parashtrimet e datës 28.02.2019.

⁴¹ Shih përgjigjen e pyetësorit të datës 23.10.2018, në dosjen e Komisionit.

- Të ardhurat nga shitja e apartamenteve në Tiranë, në bashkëpronësi me bashkëshorten (50 %).
- Në rubrikën VLERA ME SHIFRA DHE ME FJALË, është shkruar vlera 20.000 euro për blerje, 5.000 euro investim në 2013, 700.000 lekë investim në 2015, 600.000 lekë (investim + arëdim) në 2016.

6.1 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

- ZVRPP-ja Sarandë, ka konfirmuar⁴² se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar në emër të tij, pasurinë me nr. ***, me sip. 162 m², me adresë në ***, Sarandë.
- OSHEE-ja vërteton përdorimin e kësaj pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit⁴³, dhe bazuar në shpenzimet përkatëse sipas faturimeve, rezultoi se kjo pasuri përdoret nga subjekti gjatë periudhës së verës, gjë që përputhet me deklaratimet e tij.

6.2 Nga deklaratimet periodike ndër vite, rezulton se kjo pasuri:

- Është deklaruar në deklaratat periodike për vitet 2011, 2013, 2015, duke deklaruar shtim vlere të pasurisë në shumat përkatëse por, pa deklaruar burim të të ardhurave.
- Është deklaruar në deklaratën e vitit 2016, investim + arëdim në banesën e ndodhur në fshatin ***, në vlerën 600.000 lekë, (50 %) me burim krijimi të ardhurash nga shitja e apartamenteve dhe kursimet.
- Është deklaruar në deklaratën për “Vetting” si apartament banimi, me sip. 162 m², me të ardhura nga shitja e apartamenteve në Tiranë.

Nga deklaratimet periodike të viteve 2011, 2013 dhe 2015, nuk është deklaruar burimi i të ardhurave, sipas pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pranoi konstatimin e mosdeklarimit të burimit të të ardhurave, me argumentin se të ardhurat kanë qenë nga burime të ndryshme dhe ka qenë e vështirë që të bënte identifikimin. Gjithashtu, pretendon se edhe pse nuk janë deklaruar burimet e krijimit të kësaj pasurie, ato kanë qenë të justifikuar nga burime të ligjshme.

⁴² Shish shkresën nr. *** prot., datë 18.09.2018, në dosjen e Komisionit.

⁴³ Shih shkresën nr. *** prot., datë 04.12.2018, për kontratën me nr. ***, banesë në ***, në emër të z. Arqilea Koça, në dosjen e Komisionit.

Duke u nisur nga analiza financiare, sipas të cilës subjekti ka pasur burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni, çmon se pesha e pasaktësive në deklaratimet periodike lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, është e tillë që nuk ndikon në procesin e vendimarrjes.

6.3 Lidhur me origjinën e krijimit të kësaj pasurie:

Kjo pasuri e ka filluesën në vitin 2003 kur është ndërtuar objekti, për të cilin në vitin 2005 është bërë një vetëdeklarim pranë degës së ALUIZNI-t, Sarandë⁴⁴.

Duke qenë se ka pasur disa paqartësi nga ana e Komisionit lidhur me origjinën e saj, me qëllim verifikimin e çdo lloji procedure që është ndjekur për përfitimin e kësaj pasurie, deri në momentin e regjistrimit të saj pranë ZVRPP-së Sarandë, i janë kërkuar të dhëna ALUIZNI-t Sarandë dhe është pyetur subjekti i rivlerësimit.

Nga sqarimet e subjektit⁴⁵ dhe informacioni i marrë nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Sarandë,⁴⁶ është qartësuar origjina e krijimit të kësaj pasurie, si vijon:

- Më datë 21.03.2005, shtetasit S. V. D., I. P. K. (vëllai i subjektit) dhe P. K. (babai i subjektit), kanë plotësuar vetëdeklarimin për legalizim të një banese në sip. trualli 500 m², me sip. ndërtimi 140 m², në tri kate, ndërtuar në vitin 2003 në ***.

- Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 01.08.2011, z. P. K. (babai i subjektit), ka hequr dorë nga ky vetëdeklarim për pjesën e tij takuese duke ia dhënë këto të drejta djalit të tij, z. Arqilea Koça.

- Me kontratën e kalimit në pronësi të parcelës ndërtimore, nr. ***, datë 20.03.2013, është bërë kalimi në pronësi i parcelës ndërtimore me sip. 550 m², nr. ***, në emër tre bashkëpronarëve Arqilea Koça, I. K. dhe S. D. E drejta e pronësisë sipas kësaj kontrate do t'i kalojë blerësve pas përmbushjes së dy kushteve:

- Dhënia e “Lejes së Legalizimit” të objektit.
- Likuidimi i çmimit të parcelës ndërtimore, sipas “Formularit të pagesës së parcelës ndërtimore”, bashkëlidhur kësaj kontrate me nr. ***.

- Më datë 25.03.2013, është plotësuar kushti i parë i kontratës, pasi është lëshuar leja e legalizimit me nr. ***, për sipërfaqen e parcelës ndërtimore 550 m², numri i kateve mbi tokë, 3, (sip. banimi 332 m² dhe aktivitet 162 m²).

⁴⁴ Shih dokumentet në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁵ Shih përgjigjet e pyetësorit të datës 03.04.2018, dërguar në datë 13.04.2018, në dosjen e Komisionit.

⁴⁶ Shih shkresën nr. *** prot., datë 08.03.2018 në dosjen e Komisionit.

- Po kështu, u vërtetua se është përmbushur kushti i dytë i kontratës, pasi konstatohet se janë shlyer pagesat takuese për parcelën ndërtimore. Konkretisht, sipas formularit të pagesës, datë 25.02.2013, rezulton se vlera totale e parcelës ndërtimore është 1.140.648 lekë dhe se kjo pagesë do të shlyhet në bono privatizimi në shumën prej 615.000 lekësh dhe 525.648 lekë. Kjo shumë rezulton të jetë paguar terësisht.⁴⁷

- Më datë 19.02.2013, është lëshuar kartela e pasurisë së paluajtshme të legalizuar, me datë regjistrimi përfundimtar 19.02.2013, përpara se të kryhet regjistrimi i pasurisë (sipas praktikës së ndjekur nga degët e ALUIZNI-t). Nga kjo kartelë, rezulton se shuma e paguar është 1.215.504 lekë (1.140.648 lekë vlerë e parcelës ndërtimore, si me sip.+74.856 taksë e ndikimit në infrastrukturë sipas mandatpagesës me nr. serie ***, datë 27.03.2013)⁴⁸.

- Pasi janë përmbushur kriteret ligjore të përfitimit të parcelës ndërtimore, si më sipër, kontrata e kalimit në pronësi të kësaj parcele, me nr. *** datë 20.03.2013, është çuar për t'u regjistruar në ZVRPP-në Sarandë.

6.4 Lidhur me procedura të regjistrimit të kësaj pasurie në ZVRPP-në Sarandë:

Ky institucion, ka vënë në dispozicion informacion të plotë për regjistrimin e pasurisë dhe konfirmon regjistrimin e saj në emër të subjektit të rivlerësimit⁴⁹, si vijon:

- Është bërë regjistrimi i pasurisë pranë ZRVP-së Sarandë, si pasuria me nr. *** (mema) në emër të tre bashkëpronarëve, A. P. K., I. P. K. dhe S. V. D., konfirmuar dhe nga subjekti sipas vërtetimit të pronësisë me datë lëshimi 10.05.2013⁵⁰.

- Me kontratë pjesëtimi vullnetar të pasurisë me nr. ***, datë 07.05.2015, është pjesëtuar pasuria nr. ***, midis bashkëpronarëve, ku pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit përshkruhet në pikën 1 të saj, vënë në dispozicion nga noter Th. K⁵¹.

- Është regjistruar pjesa takuese e subjektit si pasuria me nr. ***, regjistruar në regjistrin hipotekor ***, indeksi ***, faqe ***, me përshkrimin: “ kati përdhe me sipërfaqe trualli 181 m² dhe sipërfaqe ndërtimi për aktivitet social-ekonomik me sipërfaqe 162 m², konfirmuar edhe nga subjekti sipas vërtetimit të pronësisë me datë lëshimi 15.06.2015⁵². Këto sipërfaqe janë regjistruar në bazë të

⁴⁷ Sipas “Formular për depozitimin e bonove të privatizimit” në “Raiffeisen Bank”, rezulton se në datë 28.02.2013, subjekti dhe bashkëpronarët e tjerë kanë depozituar bono privatizimi në shumën 615.000 lekë, ndërsa në datë 01.03.2013 është paguar shuma 525.648 lekë, sipas mandatarkëtimit nr. ***.

⁴⁸ Shih formularin e pageses së taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe mandatarkëtimit e datës 27.03.2013, bashkëngjitur shkresës nr. *** prot., datë 08.03.2018, në dosjen e Komisionit

⁴⁹ Shih shkresën nr. *** prot., datë 18.09.2018, të ZVRPP-së Sarandë, në dosjen e Komisionit.

⁵⁰ Shih dokumentet bashkëngjitur nga subjekti me kthimin e pergjigjeve të dates 13.04.2018.

⁵¹ Shih shkresën e noter Th. K., protokolluar ne nr. *** prot., datë 02.03.2013, në dosjen e Komisionit.

⁵² Shih në dosjen e ILDKPKI-së vërtetimin e ZVRPP-së Sarandë, më datë 15.06.2015.

kartelës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar. Por, në këtë kartelë pasurie⁵³, si dhe në kontratën për pjestimin vullnetar të pasurisë, vihet re se në rubrikën përshkrim i veçantë, figuron edhe një sipërfaqe baze prej 130 m². Për të sqaruar lidhur me këto sipërfaqe dhe çfarë përfaqësojnë ato, është pyetur subjekti dhe ai ka sqaruar se: *..Sipërfaqja 181 m² përfaqëson 1/3 pjesë takuese të parcelës ndërtimore prej 550 m² të kthyer në truall me aktin e legalizimit, ndërsa sipërfaqja 130 m², përfaqëson bazën e objektit sikurse pasqyrohet në genplanet që shoqërojnë vërtetimet hipotekore.*⁵⁴ *....Sipërfaqja 130 m², është sipërfaqe themelesh që takon me tokën, ndërsa sipërfaqja 162 m² është sipërfaqe ndërtimi, që del në ajër jashtë hapësirës prej 130 m²*⁵⁵

Në përfundim, lidhur me pasurinë, apartament banimi, në fshatin *** me sip. 162 m², regjistruar në ZVRPP-në Sarandë si pasuria me nr. ***, nuk ka pasur më paqartësi dhe deklarimet e subjektit përputhen me dokumentet e administruara gjatë procesit të rivlerësimit.

6.5 Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, janë deklaruar:

6.5.1 Shitja e dy apartamenteve në Tiranë, për të cilat gjatë hetimit administrativ u verifikua se:

(i) Në deklarin periodik për vitin 2009, është deklaruar shtim të ardhurash nga shitja e pasurisë ***, shuma prej 5.000.000 lekësh, përfituar me kontratë shitje me rezervë me nr. ***, datë 13.03.2009⁵⁶. Nga verifikimi i kësaj kontrate, vërtetohet se subjekti me cilësinë e shitësit Arqile Koca, ka marrë në dorëzim jashtë zyrës noteriale shumën prej 5.000.000 lekësh. Çmimi i shitjes së kësaj pasurie prej 5.500.000 lekësh, konfirmohet gjithashtu si vlera e pasurisë së shitur me nr. ***, nëpërmjet kartelës së pasurisë.⁵⁷

Lidhur me marrjen në dorëzim të kësaj shume, është pyetur subjekti i cili ka sqaruar se: *“ likuidimi i kësaj shume është bërë nga blerësi në cash, dhe ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.09.2018, lëshur nga blerësi i pasurisë, z. H. S. ”,*⁵⁸ shpjegimet e të cilit përputhen me kontratën e shitjes me rezervë.

Shpjegimet e blerësit të pasurisë, kontrata e shitjes me rezerve nr. ***, datë 13.03.2009, e cila konfirmon vullnetin e palëve (në këtë periudhë, praktikisht ka ndodhur shpesh që likuidimi i çmimit të shitjes të bëhet në cash, jashtë zyrës noteriale, prej blerësit), si dhe fakti se subjekti ka deklaruar që në vitin 2009 të ardhura nga shitja e pasurisë nr. ***, konsiderohen si prova që vërtetojnë shumën prej 5.500.000 lekësh, si e ardhur e përfituar në mënyre të ligjshme nga ana e subjektit të rivlerësimit.

(ii) Në deklarin periodik për vitin 2010, rezulton se është deklaruar si shtim të ardhurash, shitja e pasurisë nr. ***, në shumën prej 60.000 eurosh, përfituar me këtë kontratë shitje me rezervë me

⁵³ Shih te dokumentët e dërguara nga ALUIZNI Sarandë me nr. *** prot., datë 08.03.2018, në dsojen e Komisionit.

⁵⁴ Shih përgjigjet e datës 13.04.2018, pika 2.

⁵⁵ Shih përgjigjet e pyetësorit nr. 2, pika 1, në dosjen e Komisionit, datë 08.10.2018.

⁵⁶ Shih në dosjen e ILDKPKI-së, bashkëngjitur me vërtetimin e datës 24.03.2000.

⁵⁷ Shih kartelë pasurie, bashkëngjitur shkresës nr. ***, datë 02.10.2018, në dosjen e Komisionit.

⁵⁸ Shih përgjigjet për pyetësorin nr. 2, datë 08.10.2018, në dosjen e Komisionit (pyetja 9).

nr. ***, datë 04.03.2010⁵⁹. Nga verifikimi i kësaj kontrate, vërtetohet se subjekti, shitësi Arqile Koca, ka marrë në dorëzim jashtë zyrës noteriale shumën prej 60.000 eurosh. Çmimi i shitjes së kësaj pasurie në shumën prej 66.000 eurosh, konfirmohet gjithashtu si vlera e pasurisë së shitur me nr. ***, nëpërmjet kartelës së pasurisë.⁶⁰

Lidhur me marrjen në dorëzim të kësaj shume, është pyetur subjekti dhe ai ka sqaruar se: *“Likuidimi i kësaj shume është bërë në këtë mënyrë: vlera 39.000 euro në llogarinë bankare në “Tirana Bank” (ka vënë në dispozicion bashkangjitur ka dokument bankar) dhe vlera 21.000 euro, cash, jashtë sistemit bankar (ka vënë në dispozicion deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.09.2018)”*⁶¹.

Faktet sa më sipër, gjithashtu konsiderohen si prova nga Komisioni, që vërtetojnë shumën prej 66.000 eurosh si e ardhur e përfituar në mënyrë të ligjshme nga ana e subjektit të rivlerësimit.

6.5.2 Në rubrikën “Vlera me shifra dhe me fjalë”, është shkruar vlera 20.000 euro për blerje, vlera 5.000 euro investim në vitin 2013, vlera 700.000 lekë investim në vitin 2015 dhe vlera 600.000 lekë (investim + aredim) në vitin 2016.

Për verifikimin e katër vlerave të deklaruara si më sipër, janë kryer kërkime në përfundim, të të cilave ka rezultuar se subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e tyre si vijojnë:

(i) Lidhur me shumën prej 20.000 eurosh me deklaratën noteriale, nr. ***, datë 02.08.2011⁶², vërtetohet se z. P. K. (babai i subjektit), deklaroi se ka marrë jashtë zyrës noteriale shumën prej 20.000 eurosh nga djali i tij Arqilea Koça: *“Kjo shumë përfaqëson vlerën e katit të parë të objektit me tre kate, që unë (Arqile Koça) kam blerë nga z. P. K. në ***, Sarandë”*.

Ndërkohë, ILDKPKI-ja ka administruar një deklaratë tjetër noteriale me nr. ***⁶³ (pra një ditë më parë se deklarata e sipërpërmendur), ku babai i subjektit, z. P. K., deklaroi se investimi në ndërtim është kryer nga djali i tij Arqilea Koça.

Për të qartësuar situatën me këto dy deklarata, subjekti ka dhënë sqarime⁶⁴ pas të cilave, Komisioni, krijoi bindjen se deklarata, më datë 01.08.2011, është redaktuar sipas formatit që kërkohet nga dega e ALUIZNI-t, për efekt të heqjes dorë nga procesi i legalizimit dhe kalimit të pjesës takuese të z. P. K. në emër të djalit të tij subjektit të rivlerësimit, z. Arqilea Koça, dhe si e tillë është një deklaratë formale.

⁵⁹ Shih në dosjen e ILDKPKI-së, bashkangjitur me vërtetimin e datës 24.03.2000.

⁶⁰ Shih kartelë pasurie, bashkëngjitur shkresës nr. ***, datë 02.10.2018, në dosjen e Komisionit.

⁶¹ Shih përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 08.10.2018, në dosjen e Komisionit, pika 10.

⁶² Shih dosjen e ILDKPKI-së.

⁶³ Shih dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁴ Shih përgjigjen e pyetjeve të datës 03.04.2018, dërguar në datë 13.04.2018, pika 4.

Ndërsa deklarata e datës 02.08.2011, konfirmon dhënien e shumës prej 20.000 eurosh nga subjekti te babai i tij, gjë të cilën ai e ka deklaruar në deklaratën për vitin 2011, dhe që është marrë si shpenzim gjatë analizës financiare të këtij viti. Nga kjo analizë, ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për dhënien e shumës prej 20.000 eurosh në vitin 2011.

(ii). Lidhur me deklaratimet, shuma prej 5.000 eurosh është investim në vitin 2013, shuma 700.000 lekë është investim në vitin 2015, shuma 600.000 lekë (investim + aredim) në vitin 2016.

I janë kërkuar sqarime subjektit të rivlerësimit, i cili ka dhënë shpjegime duke specifikuar llojin e shpenzimeve në vitet përkatëse në këtë pasuri të cilën e ka marrë në dorëzim në gjendje karabina⁶⁵, shpenzime që kanë konsistuar në kryerjen e punimeve si suvatime, rrugën që të çon te banesa, rrethimin, kanalizime etj, si dhe shpenzime modeste arredimi për shkak se banesa përdoret rallë prej tij vetëm në muajt e verës. Subjekti deklaroi se nuk ka mbajtur fatura për punimet e kryera, përveç disa faturave që i takojnë vitit 2015, 2016, të cilat i ka vënë në dispozicion të Komisionit⁶⁶

Për këtë pasuri, i janë kërkuar të dhëna OSHEE-së për shpenzimet e energjisë elektrike dhe ky institucion ka informuar⁶⁷ se subjekti ka lidhur kontratën, më datë 19.07.2016, kohë në të cilën kanë filluar dhe pagesat. Nga pagesat mujore në shuma të vogla dhe në periudha të shkëputura kohore kryesisht gjatë verës, vërtetohet se kjo pasuri, është përdorur si banesë përkohësisht prej subjektit, gjatë kësaj periudhe, gjë që përputhet me deklaratimet e subjektit.

7. Tokë bujqësore, ndodhur në fshatin *** + themele për një banesë. Sipërfaqja e tokës 360 m². Blerë në vitin 2011, në shumën 2.200.000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten. Burimi i të ardhurave, nga shitja e apartamenteve në Tiranë.

Për këtë pasuri, ka rezultuar se:

- ZVRPP-ja Korçë⁶⁸, konfirmon pasurinë me nr. ***, ZK. *** (***), arë me sip. 360 m², në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Arqilea Koça (bashkangjitur kontratë shitje nr. ***, kartelë pasurie, certifikatë pronësie në emër të shitësit).

- OSHEE-ja⁶⁹ nuk ka dërguar informacion për këtë kontratë të lidhur me subjektin e rivlerësimit në Korçë.

7.1 Nga deklaratimet periodike ndër vite, rezulton se kjo pasuri:

⁶⁵ Shih përgjigjen e pyetësorit nr. 2, datë 24.09.2017, në dosjen e Komisionit dhe përgjigjet e pyetësorin të datës 6 nëntor 2018, dërguar në datë 12 nëntor 2018, në dosjen e Komisionit.

⁶⁶ Shih dokumentet bashkëlidhur pyetësorit të datës 7 dhjetor 2018 : Faturat për blerje të frigoriferit, TV, tavolinë ngrënie +1 lkarike, lavastovilje, që u takojnë apartamentit ku unë banoj, foto të kësaj pasurie⁶⁶ nga të cilat rezultoi se gjendja e banesës duket se përputhet me deklaratimet e subjektit për shpenzimet e kryera në këtë pasuri.

⁶⁷ Shih faturat bashkëlidhur shkresës nr. *** prot., datë 04.12.2018, për kontratën me nr. ***, banesë në ***, në emër të z. Arqilea Koça.

⁶⁸ Shih shkresën nr. *** prot., datë 15.03.2018, në dosjen e Komisionit.

⁶⁹ Shih shkresës nr. *** prot., datë 04.12.2018, në dosjen e Komisionit

- Është deklaruar në vitin 2011, tokë bujqësore, në fshatin ***, me sip. 360 m², në vlerën 700.000 lekë, pa deklaruar burim.

- Është deklaruar në vitin 2012, ndërtim themelesh për shtëpi në këtë truall në vlerën 10.000 eurosh, pa deklaruar burim.

- Është deklaruar në deklaratën “Vetting”, përshkruar si në pikën 7 më sipër.

Nga deklaratimet periodike, vihet re se në deklaratimet për vitet 2011 dhe 2012, nuk është deklaruar burimi i krijimit, sipas pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar. Duke qenë se është vërtetuar që subjekti ka pasur burime financiare për krijimin e kësaj pasurie, janë marë në konsideratë pretendimet e tij, dhe kjo pasaktësi nuk është konsideruar si shkak që mund të ndikojë në vendimmarrje.

7.2 Lidhur me origjinën dhe mënyrën e krijimit të pasurisë, u vërtetua se:

Pasuria truall është blerë me kontratë shitblerje me nr. ***⁷⁰. Mbi këtë truall, janë ndërtuar themele, sipas deklaratimit për vitin 2012, me vlerë 10.000 euro, gjë që konfirmohet me deklaratën noteriale nr. *** të shtetasit A. Sh⁷¹.

7.3 Lidhur me burimin e krijimit:

Është deklaruar shitja e apartamenteve në Tiranë, vërtetuar gjatë hetimit administrativ (arsyetuar si më sipër në këtë vendim). Nga analiza financiare, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar blerjen dhe investimin për themelet mbi këtë truall.

Sipas informacionit, vënë në dispozicion nga Dega e ALUIZNI-t⁷², nuk ka rezultuar informacion për proces legalizimi në emër të subjektit të rivlerësimit mbi këtë truall, ndërkohë që sipas informacionit të OSHEE-së⁷³, nuk figuron të këtë kontratë për furnizimin me energji elektrike në emër të subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim të hetimit administrativ për këtë pasuri, nuk pati të dhëna dhe nuk rezultoi e vërtetuar që mbi truallin e blerë me sip. 360 m², në ***, Korçë, të jetë kryer investim tjetër, veç themeleve që subjekti vetë i ka deklaruar. Deklarimet e subjektit përputhen me dokumentet e administruara.

⁷⁰ Shih shkresën nr. *** prot., datë 15.03.2018, në dosjen e Komisionit.

⁷¹ Bashkëngjitur përgjigjes së datës 13.04.2017, në dosjen e Komisionit.

⁷² Shih shkresën nr. *** prot., datë 14.07.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷³ Shih shkresës nr. *** prot., datë 04.12.2018, në dosjen e Komisionit.

8. Apartament banimi, me sip. 100 m², ndodhur në, Rr: “***”, pll. ***, ap. ***, Tiranë. Blerë në vitin 2000 në bashkëpronësi me bashkëshorten (50 %). Burimi i të ardhurave kredi lehtësuese e akorduar nga Këshilli i Ministrave. Vlera e deklaruar 5.000.000 lekë.

8.1 Për këtë pasuri rezultoi se:

- ZVRPP-ja Tiranë ⁷⁴ ka konfirmuar se kjo pasuri është regjistruar në emër të subjektit me nr. pasurie ***, si apartament me sip. 100 m², bashkëngjitur kartelë pasurie, më datë 07.02.2018, ku rezulton që pasuria është e kufizuar, për shkaqe që nuk kanë lidhje me subjektin ⁷⁵, është bërë RVP, në shumën prej 19.000.000 lekësh.

- OSHEE-ja ⁷⁶ ka konfirmuar pagesa në vlera të ndryshme, relativisht të larta, për këtë pasuri që prej janar 2007 deri në tetor 2018.

8.2 Në deklaratimet periodike, kjo pasuri është deklaruar si vijon:

- Në deklaratën e vitit 2003, apartament banimi, ndërtuar pas vitit 1990, me sip. 100 m², me vlerë 5 milion lekë. Pjesa zotëruese: 100 %. Rr “***”, Tiranë. Nr. ***. Përfitur me kredi dhe vënë në hipotekë për Bankën e Kursimeve.

- Në deklaratën “Vetting”, apartament banimi, me sip. 100 m², ndodhur në, Rr “***”, pll. ***, ap. ***, Tiranë. Blerë në vitin 2000, vlera 5.000.000 (pesë milion) lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten (50%). Burimi i të ardhurave, kredi lehtësuese e akorduar nga Këshilli i Ministrave.

- Në deklaratimet periodike, në rubrikën “detyrime financiare”, është deklaruar marrja e kredisë si burim krijimi i pasurisë, si dhe mënyra e likuidimit të kredisë vit pas viti me shumat përkatëse. Nuk kanë rezultuar pasaktësi në deklaratat periodike.

8.3. Lidhur me origjinën e krijimit të pasurisë:

Për të saktësuar çdo paqartësi, lidhur me origjinën e kësaj pasurie janë ri kërkuar të dhëna më të hollësishme nga ZVRPP-ja Tiranë ⁷⁷ si dhe janë marrë në shqyrtim dokumentet e paraqitura nga subjekti pranë ILDKPKI-së, nga të cilat, ka rezultuar se:

- Me vërtetimin e hipotekës Tiranë, më datë 07.03.2000, rezulton që apartamenti i banimit, (pa numër pasurie), me sip. 100 m², regjistruar në regjistrin hipotekor nr. *** datë 16.10.1998, figuron në emër të shtetasit A. A.

⁷⁴ Shih shkresën e ZVRPP-së Tiranë, nr. *** prot., datë 12.02.2018, në dosjen e Komisionit, pika 1.

⁷⁵ Bashkëngjitur përgjigjes së datës 13.04.2017, në dosjen e Komisionit.

⁷⁶ Shih shkresën nr. *** prot., datë 04.12.2018 si dhe dokumentet bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit.

⁷⁷ Shih dokumentet bashkëngjitur me shkresën e ZVRPP-së Tiranë, nr. *** prot., datë 20.03.2018, në dosjen e Komisionit.

- Me shkresën nr. *** prot., datë 05.01.2000, të Këshillit të Ministrave⁷⁸, konfirmohet se subjekti është në listën e funksionareve që përfitojnë kredi për strehim nga Banka e Kursimeve.

- Më datë 07.03.2000, është lidhur kontrata e shitjes me kusht me nr. ***⁷⁹, sipas të cilës apartamenti i banimit i është shitur subjektit në çmimin e shitjes 5.000.000 lekë, i cili do të paguhet me lëvrimin e një kredie nga Banka e Kursimeve.

- Më datë 24.03.2000, është lidhur kontrata e huasë me nr. ***, me Bankën e Kursimeve⁸⁰, për shumën prej 5.000.000 lekësh të marë nga subjekti me cilësinë e huamarrësit, me qëllim blerje banese.

- Më datë 24.03.2000, është lidhur kontrata e hipotekimit me nr. ***, me Bankën e Kursimeve Tirana 3⁸¹, sipas së cilës kjo pasuri është vënë si garanci hipotekore deri në shlyerjen e kredisë prej 5.000.000 lekësh.

- Më datë 20.02.2012, është lëshuar certifikatë pronësie në emër të subjektit për pasurinë me nr. *** si dhe kartelë pasurie, ku kjo pasuri figuron e bllokuar për Bankën e Kursimeve, për kredinë në shumën prej 5.000.000 lekësh, me kontratë hipoteke.⁸²

Gjatë hetimit administrativ ka pasur paqartësi për faktin se cila është mënyra e likuidimit total të çmimit të shitjes të shitesit A. A., pasi nuk është administruar asnjë kontratë përfundimtare e shitjes së kësaj pasurie.

ZVRPP-ja Tiranë⁸³ ka vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin mbi bazën e të cilit është regjistrimi i kësaj pasurie, nga origjina deri në ditën e sotme. Nga ky dokumentacion, nuk figuron të ketë kontratë përfundimtare të shitjes, po vetëm kontratë shitjeje me kusht me nr. ***, datë 07.03.2000.

Lidhur me këtë, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar dhe ka vërtetuar se:⁸⁴“...Likuidimi i shumë është bërë nëpërmjet kredisë së marrë prej meje në Bankën e Kursimeve sot “Raiffeisen Bank”, akorduar me VKM. Kjo shumë ka kaluar nëpërmjet Bankës së Kursimeve në llogarinë e shitësit në Bankën Amerikane. Nr. i llogarisë ***...me urdhërshkrimin nr. ***, datë 27.03.2000. Bashkëlidhur vërtetimi i Bankës së Kursimeve, vërtetim i cili është pjesë e kontratës..... Regjistrimi është bërë vetëm mbi bazën e kontratës nr. *** datë 07.03.2000. Në atë kohë nuk ishte praktikë bërja e një kontrate tjetër. Administrimi nga noteri i vërtetimit të përmendur më lart për kalimin e shumë

⁷⁸ Shih shkresën nr. *** prot., datë 05.01.2000, në dosjen e ILDKPKI-së (bashkëngjitur me vërtetimin, datë 20.01.2017, të Raiffeisen Bank).

⁷⁹ Shih dokumentet bashkëngjitur me shkresën e ZVRPP-së Tiranë, nr. *** prot., datë 20.03.2018, në dosjen e Komisionit.

⁸⁰ Shih dokumentet bashkëngjitur me vërtetimin, datë 20.01.2017, të Raiffeisen Bank, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸¹ Shih dokumentet bashkëngjitur me vërtetimin, datë 20.01.2017, Raiffeisen Bank, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸² Shih dokumentet bashkëngjitur me shkresën e ZVRPP-së Tiranë, nr. *** prot., datë 20.03.2018, në dosjen e Komisionit.

⁸³ Shih dokumentet bashkëngjitur me shkresën e ZVRPP-së Tiranë, nr. ***prot., datë 20.03.2018, në dosjen e Komisionit.

⁸⁴ Shih përgjigjet e datës 13.04.2018, faqja 3 (paragrafi i fundit) dhe faqja 4 (paragrafi i dytë).

konsiderohej si plotësim i kushtit duke i dhënë fuqi kontratës. Ky vërtetim është pjesë e pandarë e kontratës”.

Lidhur me origjinën e kësaj pasurie, nuk ka pasur më paqartësi e dyshime.

8.4.Të ardhura nga dhënia me qira e kësaj pasurie.

Në deklaratimet periodike dhe në deklaratën për “Vetting”, janë deklaruar :

- për vitin 2014 të ardhura nga qiratë, në vlerën 5.100 euro.
- për vitin 2015, të ardhura nga qiratë, në vlerën 5.568 euro.
- në deklaratën për “Vetting”, të ardhura në shumën prej 1.437.625 lekësh.

Pasi është pyetur subjekti lidhur me qiratë dhe pagimin e tatimit mbi to, ai ka vënë në dispozicion⁸⁵ tri kontrata qiraje me data 23.02.2015, 08.03.2016 dhe 05.12.2016, me të cilat vërteton të ardhura nga qiratë sipas deklaratimeve periodike dhe deklaratës “Vetting”, si dhe dokumente shkresore për të vërtetuar pagimin e tatimit mbi qiratë⁸⁶ sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar.

Me qëllim verifikimit e pagimit të tatimit mbi qiratë, i janë kërkuar të dhëna Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, dhe ky institucion ka vënë në dispozicion, informacion të bazuar në dokumente shkresore, me të cilat vërtetohet pagimi i tatimit mbi qiratë që nga data 01.01.2014, dhe se subjekti ka deklaruar të ardhurat neto duke zbritur tatimin mbi të ardhurat e përfituara nga qiratë e pasurive⁸⁷.

9. Autoveturë, tip “Volswagen Golf 3”, blerë në vitin 2005, në bashkëpronësi me bashkëshorten (50 %) në shumën 550.000 lekë. Burimi i krijimit, kredi e marrë në “Raiffeisen Bank” (pika 9 në kolonën “përshkrimi i pasurive”).

Për këtë autoveturë ka rezultuar se:

DSHPTR-ja konfirmon⁸⁸ se automjeti, me targa ***, figuron në emër të subjektit të rivlerësimit. Kjo pasuri është blerë me kontratën e shitblerjes, nr. ***, datë 14.11.2005, në çmimin 550 000 lekë⁸⁹, shumë shlyer tërësisht para lidhjes së saj, jashtë zyrës noteriale.

Nga deklaratimet ndër vite, nuk rezultuan pasaktësi në deklaratime.

⁸⁵ Shih dokumentet bashkëngjitur me përgjigje, datë 13.04.2018, në dosjen e Komisionit.

⁸⁶Shih përgjigjen e pyetësorit, datë 23.10.2018, në dosjen e Komisionit dhe shkresat bashkëngjitur: deklaratimin për tatimin në burim, pagesat e kryera te tatimit mbi qiranë, detyrimet në kohë reale të siguruara nga sistemi elektronik tatimor.

⁸⁷ Shih shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2018, të DPT-së në dosjen e Komisionit.

⁸⁸ Shih shkresën nr. ***prot., datë 01.02.2018, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

⁸⁹ Shih dokumentët bashkëngjitur shkresës KONFIRMIM me nr. *** prot., datë 23.01.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

Lidhur me burimin e krijimit, “Raiffeisen Bank”, ka vënë në dispozicion kontratën e kredisë pa akt noterial, më datë 16.11.2005⁹⁰, ku rezulton që kredia prej 400.000 lekësh, është marrë me qëllim blerje makine jo të re, si dhe praktikën përkatëse mbi marrjen e kredisë nga subjekti i rivlerësimit. Ndërkohe, nga aktet rezulton që mjeti është blerë një ditë më parë se të merrej kredia (datë 15.11.2005). Gjithashtu është konstatuar se ndonëse burim për blerjen e mjetit, është deklaruar kredia në shumën prej 400.000 lekësh, çmimi i blerjes se mjetit është 550.000 lekë.

Në lidhje me këto konstatime, është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili ka sqaruar se: “⁹¹...Automjeti është blerë duke përdorur kredinë prej 400.000 lekësh dhe duke plotësuar shumën e blerjes me kursimet e mia.Në lidhje me mospërputhjen në data mund të them se pas konsultimit me përfaqësues të bankës mbi procedurat e dhënies së kredive të tilla në atë kohë, hartimi i kontratës u bë pas konfirmimit që oficeri i kredisë më bëri për miratimin e kredisë (kisha kontaktuar bankën disa ditë më parë) bazuar në dokumentet e çuara prej meje dhe verifikimet e bëra prej bankës mbi të ardhurat e mia. Nga verifikimi rezulton se pas këtij konfirmimi, më datë 14.11.2005, është bërë kontrata, më datë 15.11.2005, unë kam bërë aplikimin dhe më datë 16.11.2005 është bërë disbursimi. Pra kontrata është bërë paraprakisht në kushtet e sigurisë që unë mora në lidhje me kredinë si dhe në kushtet e nevojave të ngutshme për autoveturë. Nga ana e shitësit u pranua të hartohej kontrata pa i dhënë ende gjithë shumën për shkak të rrethanave të mirëbesimit që u krijuan”, shpjegime të cilat janë konsideruar bindëse nga ana e Komisionit.

Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare për pagesën e diferencës prej 150.000 lekësh për të cilën ka deklaruar se janë nga kursime familjare.

10. Autoveturë, tip “Honda”, blerë në 27 janar 2017, në shumën 1.300 000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten (50 %). Aktualisht në proces kalimi pronësie. **Nuk është pasqyruar burimi i krijimit të të ardhurave** (pika 10 në kolonën “përshkrimi i pasurive”).

DPSHTRR-ja⁹² ka konfirmuar se ky automjet figuron në emër të subjektit të rivlerësimit. Mjeti është blerë me kontratën e shitjes, datë 27.01.2017, me çmim blerjeje 1.300.000 lekë, të paguara jashtë zyrës noteriale.

Nga analiza financiare, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjeti.

Nuk ka pasur paqartësi e dyshime për këtë pasuri.

11. Gjendja e likuiditetit në sistemin bankar, në vlerën 1.400.036 lekë, dhe 1421 euro në bashkëpronësi me bashkëshorten (50 %), pa deklaruar burim krijimi.

⁹⁰ Shih kontratën e kredisë në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹¹ Shih përgjigjet, datë 13.04.2018, në dosjen e Komisionit.

⁹² Shih shkresën nr. *** prot., datë 01.02.2018, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

Nga verifikimi i dokumenteve bankare⁹³ rezulton se, më datë 23.01.2017, subjekti ka depozituar në “Credins Bank” në shumën 1.300.000 lekë, nga gjendja *cash* në fund të vitit 2016, të cilat i ka pasur në shumën 3.600.000 lekë, të cilat justifikohen me të ardhura të ligjshme.

12. Gjendja e likuiditetit jashtë sistemit bankar, në vlerën prej 1.000.000 (një milion) lekësh, në bashkëpronësi me bashkëshorten (50 %), pa deklaruar burimin.

Gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se në deklaratat periodike, ka pasur paqartësi lidhur me gjendjen *cash* (shitesa/pakësimet/ndryshimet e pasurisë) të deklaruara në fund të çdo viti nga subjekti. Për këtë arsye, i është kërkuar atij të deklarojë gjendjen *cash* me vendndodhje në banesë dhe brenda sistemit bankar në fund të çdo viti për periudhën 2003 - 2016⁹⁴.

Në tabelën më poshtë janë pasqyruar likuiditetet në *cash* sipas deklaratave periodike dhe përgjigjeve të pyetësorit nr. 2⁹⁵.

Gjendja e likuiditeteve														
Vitet	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Sipas pyetësorit	100000	450000	400000	800000	800000	1200000	4200000	5200000	700000	900000	1700000	10000	4100000	3600000
Sipas deklaratimeve				800000	800000	1200000	4473640	6694600	3698820	3698820	3979240	3979240	7879240	

Siç shihet, rezulton se, subjekti i rivlerësimit, nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë gjendjen e likuiditetit *cash* për vitet 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 .

LIDHUR ME STATUSIN SI I PASTREHË:

Gjatë hetimit administrativ, u vërtetua se subjekti ka përfituar me shumë se një herë, kredi me statusin si i pastrehë, sipas VKM-së, nr. 102, datë 05.03.1999, status i konfirmuar me shkresën nr. * prot., datë 05.01.2000, të Këshillit të Ministrave.⁹⁶**

Konkretisht me kontratën e huas me nr. ***, datë 24.03.2000, me palë, huadhënës Banka e Kursimeve dhe palë huamarrëse, z. Arqilea Koça, ky i fundit ka përfituar një kredi në shumën prej 5.000.000 lekësh, me statusin e të pastrehut, për blerjen e pasurisë, apartament banimi, me sip. 100 m², ndodhur në Rr: “***”, pll. ***, ap. ***, Tiranë.

⁹³ Shih shkresën nr. *** prot., datë 13.03.2018 te Credins Bank.

⁹⁴ Shih pyetësorin nr. 2, pyetja 5, dërguar në datë 8.10.201.

⁹⁵ Shih përgjigjen e subjektit për pyetësorin nr. 2, dërguar më datë 8.10.2018.

⁹⁶ Shih dokumentet bashkëngjitur vërtetimit të Raiffeisen Bank, më date 20.01.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

Disa muaj pas përfitimit të kësaj kredie, konkretisht, më datë 05.07.2000, subjekti ka privatizuar një pasuri të paluajtshme po me statusin e të pastrehut, në qytetin e Korçës.

Lidhur me këtë pasuri është konstatuar se subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, të ardhura të përfituara nga shitja e një apartamenti në qytetin e Korçës, të fituar nëpërmjet privatizimit, me sip. 100 m², me kontratën nr. ***, datë 26.03.2001, në vlerën prej 1.250.000 lekësh.

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga ZVRPP-ja Korçë⁹⁷ dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit⁹⁸ janë vërtetuar faktet si vijojnë :

- **Më datë 05.07.2000, është lidhur kontratë privatizimi banese me ish-NKB, formulari nr. ***, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit me statusin e të pastrehut, ka privatizuar ambient 1 dhomë, 1 kuzhinë me aneks (pallati ish-artistike) në shumën 72.000 lekë, e cila sipas kësaj kontrate, rezultojn të jenë shlyer menjëherë me zbritje 20 %, me mandatarkëtimin nr. *** të po kësaj date.**
- Më datë 14.07.2000, është bërë vërtetimi i nënshkrimit të palëve në këtë kontratë : palë shitëse, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe palë blerëse, subjekti i rivlerësimit.
- Kjo pasuri është regjistruar pranë ZVRPP-së Korçë, si pasuria me nr. ***, e llojit truall me sip. 100 m², dhe 100 m² ndërtesë në Korçë.
- Me kontratën e shitjes nr. ***, është shitur pasuria me nr. ***, në vlerën prej 1.250.000 lekësh.
- Kjo shumë nuk është deklaruar si e ardhur ne deklarin periodik për vitin 2003, por është deklaruar si e ardhur në deklarinim për “Vetting”.
- Me certifikatën familjare të datës 24.10.2018⁹⁹, vërtetohet se subjekti ka bërë shkëputjen nga gjendja civile e Korçës, më datë 14.06.2002, pra 8 vite pasi ka filluar punë në Tiranë dhe ka banuar po në këtë qytet.
- I pyetur në lidhje me përfitimin e kësaj pasurie me statusin e si i pastrehë, si dhe me faktin nëse kjo pasuri ka qenë apartament banimi apo godinë e ish ndërmarrjes artistike, subjekti deklaroi se: *“...në momentin e kërkesës dhe aprovimit të kredisë nuk kam pasur në pronësi banesë në qytetin e Korçës. Unë jam bërë pronar i saj në korrik të vitit 2000, nëpërmjet kontratës së privatizimit të banesës, datë 05.07.2000 (bashkëlidhur), pasi kam pasur statusin si i pastrehë”* Gjithashtu subjekti ka paraqitur shkresën, nr. ***, datë 20.07.1999, të Prokurorisë së Përgjithshme, ku rezultoi se ai ka fituar statusin e te pastrehut. Në vijim, subjekti shprehet se: *“...sikurse shihet dhe në kontratën e privatizimit, edhe pse përshkruhet si banesë, evidentohet fakti se hapësira është “ish artistike”, ç’ka nënkupton se ishte një pjesë e ish-ndërmarrjes artistike, magazinë dhe jo banesë. Formulari për privatizimin e banesës ka qenë standard dhe për këtë arsye mund të krijojë paqartësi. Në këtë formular evidentohet që ky “apartament” i ndërtuar në vitin 1940, përbëhet nga një dhomë. Pra është një ndërtim i vjetër, para çlirimit*

⁹⁷ Shih dokumentet bashkëngjitur shkresës nr. *** prot., datë 12.03.2018, të ZVRPP-së Korçë, në dosjen e Komisionit dhe shkresën nr. *** prot., datë 15.03.2018, të ZVRPP-së Korçë.

⁹⁸ Shih përgjigjen e pyetesorit të dytë, dërguar, më datë 08.10.2018, pika 2, në dosjen e Komisionit.

⁹⁹ Akt i depozituar në prapësimet e subjektit, në dosjen e Komisionit.

dhe në dijeninë time, nuk ka qenë në fondin e banesave të NKB Korçë. Nga Bashkia e qytetit, ambientet e ish-ndërmarrjes artistike janë përdorur për trajtimin e personave të pastrehë dhe sikurse kam shpjeguar, ambienti nuk ka qenë i banueshëm.Unë në këtë qytet kisha statusin si i pastrehë në kategorinë e qiramarrësit në banesë private e për këtë arsye nga ana Bashkisë jam trajtuar me këtë ambient”.

Arsyetim ligjor :

Nga të gjitha sa më sipër, gjatë hetimit administrativ, është konstatuar se:

1. Subjekti ka përfituar, me statusin si i pastrehë, në korrik të vitit 2000, një pasuri në Korçë, truall me sip. 100 m² dhe ndërtesë me sip. 100 m², pasi në mars të vitit 2000, ai e kishte konsumuar marrjen e kredisë prej 5.000.000 lekësh për blerjen e një banese në Tiranë, duke vepruar në kundërshtim me vendimin nr. 102, datë 05.03.1999, pika 2, “Për trajtimin në strehim të funksionareve politikë”. Sipas pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha” të cilit i referohet VKM-së nr. 102, datë 05.03.1999, parashikohet se, me përdorimin e shumës së përfituar, familjes i hiqet statusi i si i pastrehë.

Pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore, lidhur me këtë konstatim, subjekti vlerëson se :“.. përfitimi i pasurisë në qytetin e Korçës ka qenë një e drejtë që mua më ka takuar qysh me fillimin e marrëdhënieve të punës në atë qytet në vitin 1989 që ka ardhur për shkak se pushteti lokal nuk ka përmbushur detyrimin për strehimin e tij gjatë periudhës që ka banuar në Korçë. ... Në këtë aspekt, përfitimi i kësaj pasurie ishte realizim i vonuar i një të drejte që i takonte”. Po kështu, rithekson se: “... pasuria e mësipërme në vetvete nuk përbënte një apartament të banueshëm sikurse ka qenë detyrimi i pushtetit lokal, por një magazinë të vjetër, të rrënuar dhe të pabanueshme, e ndërtuar në vitin 1940. ...”. Gjithashtu subjekti konsiston të argumentojë me faktin se privatizimi i pasurisë “... ishte përfundimi i një procesi bazuar në një kërkesë të bërë për strehim qysh kur punonte në Korçë pra, para se të aplikonte për kredi dhe që rastësisht u realizua menjëherë pas marrjes së kredisë. Vetë qasja e kohës nuk e konsideronte të padrejtë këtë përfitim që vetë shteti ta ofronte si mbështetje për realizimin sa më të mirë të funksionit....Përveç sa më sipër, sikurse kam shpjeguar, marrja e kredisë nuk nënkuptonte domosdoshmërisht zgjidhjen e strehimit në mënyrë përfundimtare për aq kohë sa ajo ishte kolateral për garantimin e shlyerjes së kredisë...”.

2. Në kontratën për privatizimin e banesës, datë 05.07.2000, palë shitëse është ish-NKB, ndërkohë në vërtetimin e nënshkrimit të kësaj kontrate, palë shitëse rezulton të jetë Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

3. Vetë subjekti deklaron se pasuria është përfituar për shkak të një të drejte për strehim që ai e ka pasur në periudhën kur ka punuar në Korçë. Ndërkohë, nga vetëdeklarimet e subjektit, nuk

rezultoi e vërtetuar që ai të këtë banuar me statusin e ish-qiramarrësit në një banesë të ish-NKB, të cilin do të mund që ta privatizonte me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7652/1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Gjithashtu, nga deklaratimet e tij, por dhe dokumentet e administruara, u vërtetua se, kjo pasuri nuk ka qenë pronë e ish-NKB-së, por ka qenë në pronësi të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

4. Është e paqartë se, si është përfitur dhe si është regjistruar në emër të subjektit sipërfaqja e objektit prej 100 m², dhe aq më tepër sipërfaqja prej 100 m² truall, ndërkohë që kontrata për privatizim banese, shprehet për një apartament një dhomë, një kuzhine me aneks, ndërkohë që vetë subjekti ka pranuar duke deklaruar se pasuria përbëhej vetëm nga një dhomë. Me ligjin për privatizimin e banesave ish pronë e NKB-së 7652/1992 lejohej privatizimi vetëm i apartamenteve të banimit në posedim me qira nga banorët, dhe jo i trojeve të objekteve.

Nga të gjitha sa më sipër, trupi gjykues krijoi bindjen se :

- (i) Privatizimi i pasurisë në Korçë, përfitur nga subjekti me statusin si i pastrehë, më datë 05.07.2000, pasi ai kishte marrë kredi në Tiranë, më datë 20.03.2000, po me statusin si i pastrehë, pasuri e shitur brenda vitit të privatizimit, më datë 26.03.2001 është përfitur në kundërshtim me VKM-në nr. 102, datë 05.03.1999, në mënyrë të padrejtë dhe me qëllim përfitimi nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke përdorur funksionin e tij si prokuror.**

Argumenti se kjo pasuri ishte një e drejtë që i takonte, nuk qëndron, pasi me transferimin në Tiranë, (ku dhe për shkak të punës ka marrë kredi si i pastrehë), e drejta për t’u strehuar në qytetin e Korçës, kishte përfunduar. Është e pakuptueshme përse subjekti ka vijuar të ketë gjendjen civile në qytetin e Korçës në momentin e privatizimit të pasurisë në këtë qytet, ndërkohë që ai kishte 4 vjet që banonte në Tiranë. Është i pakuptueshëm dhe i papranueshëm për një prokuror të shkallës së lartë, argumentimi i tij se: “ *vetë qasja e kohës nuk e konsideronte të padrejtë këtë përfitim që vetë shteti ta ofronte si mbështetje për realizimin sa më të mirë të funksionit*”. Në ndihmë të realizimit të funksionit të tij në Tiranë ku ishte caktuar për të punuar, ka qenë pikërisht aprovimi i kredisë në kushte lehtësuese, që ai mori për blerje banese në Tiranë.

Privatizimi i një pasurie në Korçë, ku ai nuk ishte duke ushtruar më funksionet e tij, shitja e kësaj pasurie brenda vitit kur fitoi titullin e pronësisë, tregon se qëllimi i privatizimit të kësaj pasurie nuk i shërbeu ushtrimit të detyrave nga ana e tij, dhe nuk ishte as për shkak të pasigurisë për shkak të humbjes së pronësisë mbi pasurinë në Tiranë siç subjekti pretendon (pasi ajo ka qenë kolateral deri në shlyerjen e kredisë), por fitimi i disa të ardhurave, të cilat i ka përdorur si burim për krijimin e pasurive të fituara më pas, ashtu sikurse vetë subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting”.

- (ii) Privatizimi i pasurisë në Korçë, më datë 05.07.2000, pa e pasur atë në posedim si qiramarrës (siç ligji e kërkonte), dhe në një kohë që kjo pasuri nuk ka qenë apartament banimi në pronësi të ish NKB-së, por objekt i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”.
- (iii) Subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga shitja e kësaj pasurie në deklarin për vitin 2003, por vetëm në deklarin për “Vetting”.

Lidhur me këtë pasaktësi në deklarin për vitin 2003, iu kalua barra e provës dhe ai shpjegoi se: “ ... shitja e pasurisë në qytetin e Korçës është bërë në vitin 2001, ndërkohë që deklarimi i vitit 2003, si deklarim për herë të parë kërkonte pasqyrimin e situatës fillestare të pasurive. ... nga ana tjetër, në periudhën 2001-2003 nuk ishte krijuar ndonjë pasuri me burim të ardhurat nga shitja e asaj pasurie. Pra, në formular nuk kishte një rubrikë që të evidentonte detyrimin tim për deklarin e një të ardhure të krijuar dy vjet më parë se deklarimi fillestar, ndërkohë që ajo nuk kishte krijuar ndonjë pasuri. Rikujtoj se ai ka qenë deklarimi i parë dhe unë si të gjithë deklaruesit, kisha paqartësi në plotësimin e tij.. ”.

Nga ky deklarim, subjekti pranon se me të ardhurat nga shitja e pasurisë në Korçë, ai nuk kishte krijuar ndonjë pasuri të re (sikurse është evidentuar edhe gjatë hetimit administrativ). **Pra në vitin 2003, ai ka pasur një likuiditet në shumën prej 1.250.000 lek, të cilat nuk i ka deklaruar në deklarin periodik për vitin 2003, sipas parashikimit të shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, por i ka deklaruar si e ardhur ligjore vetëm në deklaratën “Vetting”, sipas detyrimit ligjor të shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016.**

Veç sa më sipër, siç u argumentua më sipër në këtë vendim, përfitimi i pasurisë në Korçë, e cila ka krijuar të ardhurën prej 1.250.000 lekësh, ka qenë i paligjshëm, si rrjedhim të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie, konsiderohen nga Komisioni si të ardhura të paligjshme.

Në përfundim, lidhur me sa më sipër, Komisioni, vlerëson se subjekti ka kryer:

- (i) **Mosdeklarimin e shumës prej 1.250.000 lekësh, në deklaratën për vitin 2003.**
- (ii) **Deklarim të rremë në deklaratën “Vetting”, parashikuar në neni 33, pika 5, germa “ç” të ligjit nr. 84/2016, për shkak të deklarimit si e ardhur e ligjshme të shumës prej 1.250.000 lekësh.**

LIDHUR ME PASURI TË TJERA NË POSEDIM APO NË PRONËSI TË SUBJEKTIT, NË MOMENTIN E PËRFITIMIT TË KREDISË PREJ 5.000.000 LEKËSH, SIPAS VKM-SË NR. 102, DATË 05.03.1999.

A. Në vitin 1996 subjekti ka ndërtuar një banesë-objekt provizor, me sip. 36 m², ndodhur në ***, ***, Tiranë.

Lidhur me këtë objekt nga informacioni dhe dokumentet e vëna në dispozicion nga ALUIZNI dega Tiranë¹⁰⁰ si dhe nga përgjigjet dhe dokumentet shkresore të subjektit të rivlerësimit¹⁰¹ ka rezultuar se:

- **Objekti është ndërtuar në vitin 1996 pa leje nga organet kompetente, mbi një sipërfaqe toke prej 830 m², ndodhur në Linzë, Tiranë, për të cilën nuk ka pasur titull pronësie.**
- Në këtë objekt, subjekti ka banuar në periudhën 1996 – 2000.
- Me kontratën nr. ***, datë 04.05.2000, subjekti bleu pasurinë tokë arë, me sip. 830 m² nga shtetasi F. A., të cilën e ka deklaruar në deklarin periodik për vitin 2003.
- Më datë 17.03.2005, **subjekti ka bërë vetëdeklarimin për legalizim të objektit shtëpi banimi, me sip. 36 m², ndërtuar në vitin 1996, duke deklaruar se kërkesa për legalizim është bërë me qëllim kthimin e tokës ARË në truall për ndërtim¹⁰².**
- **Subjekti nuk e ka deklaruar këtë objekt informal në deklarin periodik për vitin 2003,** sipas parashikimit të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar.
- Objekti është prishur nga shoqëria “****” sh.p.k., në vitin 2006 dhe për këtë shkak subjekti ka përfitur shpërblim në formën e qirasë nga ana e shoqërisë ndërtuese.
- Mbi truallin me sip. 830 m² shoqëria “****” sh.p.k., ndërtoi një pallat shumëkatësh, nga i cili subjekti përfitoi tetë pasuri të paluajtshme.
- Pas kërkesës së subjektit, gjatë procesit të rivlerësimit të tij, me urdhrin nr. ***, datë 20.09.2018, të Drejtorit të Drejtorisë së ALUIZNI-t Tiranë është bërë përjashtimi i tij nga procedurat e legalizimit të objektit.
- Në lidhje me këtë objekt, subjekti veç të tjerash deklaroi se : “... objekti provizor barakë është prishur dhe mbi të dhe sipërfaqen tjetër është ndërtuar një pallat Gjithashtu në deklarinimet e mia periodike vjetore unë kam deklaruar edhe përfitimet nga shoqëria “****” sh.p.k., si qira, për prishjen e barakës në vitet 2006, 2007, 2008, vërtetuar me vërtetimin e datës 26.01.2017¹⁰³..... Për blerjen e kësaj toke bujqësore është rënë dakord me pronarin e tokës që në vitin 1996, dhe shlyerja e saj do të bëhej me këste. Shlyerja përfundimtare është kryer me hartimin e kontratës së shitjes në vitin 2000. Kontrata e shitjes nuk është realizuar që në vitin 1996 për arsye se pritej miratimi i një akti normativ që të lejonte shitjen e tokës bujqësore.... Unë kam filluar ndërtimin e barakës (objekti provizor) në vitin 1996. Ky objekt nuk kishte

¹⁰⁰ Shih shkresën e ALUIZNI-t, nr. *** prot., datë 14.07.2017, ë dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën, nr. *** prot., datë 20.03.2018, në dosjen e Komisionit.

¹⁰¹ Shih përgjigjet për pyetjet, datë 03.04.2018, derguar, më datë 13.04.2018, në dosjen e Komisionit, faqe 5, paragrafi i fundit. Shih përgjigjet e pyetesorit nr. 2, derguar nga subjekti, më datë 18.10.2018, në dosjen e Komisionit, pika 11, shih përgjigjet e pyetjeve shtesë për pyetesorit nr. 2, datë 19.10.2018, në dosjen e Komisionit..

¹⁰² Shih përgjigjen e pyetesorit nr. 4, datë 17.10.2018, në dosjen e Komisionit.

¹⁰³ Shih në dosjen e ILDKPKI-së.

themele, ishte i ndërtuar me blloqe betoni, dhe me materiale kryesisht të përdorura, i mbështetur në murin e avllisë së komshiut. Ishte një ndërtim provizor. Qëllimi real i legalizimit në kushtet kur objekti ishte provizor, ka qenë që toka bujqësore të kthehej në truall, dhe kjo do të lehtësonte marrjen e një leje ndërtimi për një objekt përfundimtar...”.

Arsyetim ligjor:

Nga të gjitha faktet dhe rrethanat si më sipër, pavarësisht pretendimeve të subjektit se ndërtimi i objektit është bërë pas marrëveshjes verbale me shtetasin F. A., Komisioni, vlerëson se, në kushtet kur u vërtetua se ky shtetas nuk ka pasur titull pronësie dhe as një AMTP në formën e kërkuar nga ligji (AMTP e vitit 1992, rezulton të jetë plot fshirje e korrigjime, për t’u konsideruar i rregullt nga pikëpamja e një dokumenti shkresor ligjor), marrëveshja verbale me shtetasin F. A. në vitin 1996, nuk e legjitimonte subjektin të investonte mbi tokën me sip. 830 m², qoftë edhe në një objekt provizor, ku ka banuar për disa vite, nga e cila më pas, ka përfituar tetë pasuri të paluajtshme.

Në këto kushte, faktet e vërtetuara, se subjekti ka ndërtuar në vitin 1996 në mënyrë të paligjshme një objekt, mbi një tokë që nuk ka qenë në pronësinë e tij, por as në pronësinë legjitime të z. F. A, duke vijuar me kërkesën e vitit 2005 për legalizim të këtij objekti, vetëm me qëllim kthimin e tokës bujqësore në truall, për efekt të ndërtimit të një objekti të përhershëm mbi të, janë fakte të cilat tregojnë veprime me qëllim përfitimi nga ana e subjektit, prandaj dhe mosdeklarimi i objektit prej 36 m², nuk duhet konsideruar thjesht si pasaktësi në deklarin periodik për vitin 2003.

Lidhur me kete pasaktësi ne deklarim, subjekti parashtrroi pretendimet e tij, sipas të cilave ai ka qenë i paqartë nëse një ndërtim provizor në mungesë të kushteve teknike të ndërtimit, do të duhej të deklarohet, dhe se ka qenë i paqartë në plotësimin e formularit për vitin 2003, i cili ka qenë dhe viti i parë i deklarinimit. Ndërkohë, vihet re se subjekti, ashtu sikurse nuk ka deklaruar në deklarinimin periodik për vitin 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, tetë pasuri në posedim, por ka deklaruar të ardhura nga shitja e dy prej tyre (arsyetuar si më sipër), edhe në këtë rast, ai nuk ka deklaruar pasurinë në posedim në deklarinimin për vitin 2003, po ka deklaruar të ardhura nga prishja kësaj pasurie (në deklarinimet periodike për vitet 2006, 2007 dhe 2008), të përfutuara si dëmshpërblim nga shoqëria “***” sh.p.k. **Pra në mënyrë të përsëritur, subjekti nga njëra anë nuk deklaron pasuri në posedim, por nga ana tjetër, deklaron rregullisht të ardhura të përfutuara prej tyre.**

Në vlerësimin tërësor të rrethanave, Komisioni, krijoi bindjen se shkak i mosdeklarinimit të objektit me sip. 36 m², në *, Tiranë, ne deklaratën periodike për vitin 2003, ka qenë pikërisht fakti se ky objekt ka qenë një ndërtim informal, dhe se, në tërësinë e veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit, kjo pasaktësi duhet të merret në konsideratë, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, si provë me të njëjtën rëndësi sa dhe deklarinimet e pasakta e të pamjaftueshme në deklaratën Vetting, sipas parashikimit të nenit 32 pika 5 të ligjit 84/2016.**

Lidhur me marrjen e kredisë lehtësuese, u konstatua se :

- Në kohën e marrjes së kredisë, datë 20.03.2000, edhe pse subjekti nuk ka qenë pronar *de jure* mbi sip. 830 m² (të cilën e bleu juridikisht tre muaj pas përfitimit të kredisë), ai ka qenë posedues real i kësaj pasurie që nga viti 1996.

- Subjekti ka banuar që nga viti 1996 - 2000, në objektin me sip. 36 m², në ***, Tiranë, pra ka pasur një banesë (ndonëse provizore siç subjekti pretendoi dhe vërtetoi). Sipas parashikimit të pikës 6 të VKM-së nr. 102, datë 05.03.1999, ai duhet të përfitonte kredi në shumën 2.500.000 lekë, si funksionar që ka pasur nevojë për sipërfaqe shtesë banimi, dhe jo kredi në shumën prej 5.000.000 lekësh.

Nisur nga ky fakt, por edhe nga vlerësimi tërësor i rrethanave, Komisioni çmon se subjekti ka përfituar kredinë lehtësuese me statusin e të pastrehut, në tejkalim të kritereve të parashikuara në VKM-në nr. 102, datë 05.03.1999.

Në përfundim, lidhur me objektin prej 36 m/2 në * Tiranë ***, Komisioni vlerëson se veprimet dhe mosveprimet e subjektit në lidhje me këtë objekt:**

- (i) të ndërtuar në mënyre të paligjshme në vitin 1996, mbi një truall që nuk ka pasur titull pronësie;
- (ii) të padeklaruar në deklarin periodik për vitin 2003, prej të cilit ka përfituar të ardhura në vitin 2016;
- (iii) të poseduar faktikisht prej tij për katër vite dhe truallin e të cilit e bleu juridikisht vetëm tre muaj pasi ka përfituar kredinë lehtësuese si i pastrehë;
- (iv) objekt për të cilin subjekti ka kërkuar leje legalizimi në vitin 2005, vetëm për efekt të kthimit të tokës bujqësore në truall për ndërtim, dhe mbi të cilin me pas;
- (v) është ndërtuar një objekt i përhershëm, nga i cili janë përfituar tetë pasuri të paluajtshme; si dhe
- (vi) veprimet në lidhje me përfitimin e kredisë në kushte lehtësuese, në tejkalim të ligjit,

duhet të merren në konsideratë në vlerësimin përfundimtar gjatë procesit të vendimmarrjes, si veprime apo mosveprime që vijnë në kundërshtim me etikën e një prokurori të Prokurorisë së Përgjithshme, emëruar në këtë funksion që nga viti 1994, dhe që çenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

B. Në momentin e marrjes së kredisë, datë 20.03.2000, por edhe të plotësimit të deklaratës “Vetting”, subjekti ka qenë bashkëpronar në ¼ pjesë të pandarë mbi pasurinë me nr. ***, apartament banimi, me sip. 92.45 m², ndodhur në Delvinë, e përfituar nga privatizimi i banesave

shtetërore në vitin 1993, me kontratën e datës 12.07.1993, sipas informacionit ZVRPP-së Sarandë¹⁰⁴.

Kjo pasuri, nuk është deklaruar në deklarin periodik për vitin 2003, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar. Ndërkohë që sipas nenit D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të deklaronte këtë pasuri në mënyrë të saktë, në deklaratën “Vetting”, gjë që nuk e ka bërë.

Lidhur me mosdeklarimet e kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit sqaron se: “¹⁰⁵... nuk kam qenë apo jam bashkëpronar në ndonjë banesë në Sarandë. Nëse bëhet fjalë për banesën e prindërve në Delvinë. Ju informoj se në lidhje me faktin se unë isha bashkëpronar në këtë banesë, jam vënë në dijeni nga prindërit e mi vetëm në vitin 2011. Kjo pasi unë në vitin 1993, kur është bërë privatizimi i saj, isha me punë në qytetin e Korçës prej tre vjetesh (vërtetohet me certifikatën familjare, me datë lëshimi 01.11.1992, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Delvinë)¹⁰⁶. Sipas shpjegimit të prindërve, ata më përfshinë mua në dokumentet e privatizimit sepse ende në atë moment gjendja ime civile figuronte në Delvinë. Me marrjen dijeni të këtij fakti, unë nëpërmjet deklaratës noteriale, nr. ***, datë 02.08.2011, pranë noterit A. A., kam deklaruar heqjen dorë nga të drejtat e mia mbi këtë banesë duke ia kaluar ato nënës sime M. K.”. Subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën nr. ***, datë 02.08.2011 për heqjen dorë nga bashkëpronësia.

Nga shpjegimet e subjektit dhe provat e grumbulluara, Komisioni, çmon se bashkëpronësia mbi ¼ pjesë të pandarë mbi pasurinë apartament banimi në Delvinë, nuk mund ta pengonte subjektin që të përfitonte kredinë si i pastrehë në vitin 2000 në Tiranë, ku ai po ushtronte funksionin si prokuror.

Ndërsa, në lidhje me mosdeklarimin e pronësisë mbi ¼ pjesë të pandarë në pasurinë apartament banimi në Delvinë, pavarësisht pretendimit të subjektit se nuk ka qenë në dijeni në vitin 2004 (kur është plotësuar deklarata për vitin 2003) mbi këtë bashkëpronësi, si dhe pavarësisht nga faktit se ai ka hequr dorë nga e drejta e pronësisë me deklaratë noteriale të vitit 2011, Komisioni, çmon se në momentin e plotësimit të deklaratës periodike për vitin 2003, dhe aq më shumë në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting”, subjekti ka pasur detyrim për verifikimin e çdo lloj pasurie në pronësi të tij (qoftë dhe *de jure*), me qëllim plotësimin e kësaj deklarate me vërtetësi dhe saktësi sipas parashikimit të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Shpjegimi i subjektit se prindërit më përfshinë mua në dokumentet e privatizimit...nuk e justifikon atë në mosveprimet e tij, pasi qenia e tij si bashkëpronar në këtë pasuri, është një e drejtë që i është dhënë nga ligji nr. 7652/1992, si anëtar madhor i përbërjes së

¹⁰⁴ Shih shkresën nr. ***, datë 18.09.2018, të ZVRPP-së Sarandë, në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁵ Shih përgjigjen e pyetësorit të dytë, dërguar në datën 08.10.2018, pika 2, në dosjen e Komisionit

¹⁰⁶ Shih certifikatën familjare bashkëngjitur shkresës nr. *** prot., datë 18.09.2018, të ZVRPP-së Sarandë, në dosjen e Komisionit

certifikatës familjare në gjendjen civile të vitit 1992, dhe jo për shkak të përfshirjes që prinderit i kanë bërë, dhe si e tillë duhej deklaruar me saktësi nga subjekti i rivlerësimit.

Në këto kushte, konstatohet se deklaratimet për vitin 2003 dhe atë “Vetting” janë të pasakta, edhe pse mosdeklarimi i ¼ pjesë të pasurisë në Delvinë, në vetvete nuk ka qënë me qëllim fshehjen e kësaj pasurie. Por, Komisioni çmon që ta konsiderojë këtë pasaktesi në harmoni me provat e tjera, gjatë procesit të vendimmarrjes.

I. LIDHUR ME KRITERIN E FIGURËS

Me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar me vendim të KDZH-së, nr. ***, datë 28.03.2018, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, pasi përfundoi kontrollin e plotë të deklaratës së kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Arqilea Koça, sipas informacioneve të ardhura nga institucionet e verifikimit, ka konkluduar se:

- Formulari i deklaratimit është i plotë i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me ligjin nr. 84/2016.
- Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

Gjatë hetimit administrativ, nuk ka pasur të dhëna dhe dyshime lidhur me pastërtinë e figurës së subjektit.

II. LIDHUR ME KRITERIN E AFTËSIVE PROFESIONALE

Sipas nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit, bazuar në :

1. Raportin për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Grupi i Punës i ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 24.04.2018.

Ky raport, i referohet të dhënave të nxjerra nga, formulari i vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti, pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short, si dhe të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme. Në përfundim, Grupi i Punës, ka vlerësuar si vijon:

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, prokuror Arqilea Koça, interpreton dhe zbaton drejt ligjin. Konstatohet se, në të tre dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vet subjekti, ashtu dhe në pesë dosjet e zgjedhura në mënyrë rastësore me short, gjuha e përdorur në akte është e kuptueshme, logjike dhe u është përmbajtur me korrektesë rregullave drejtshkrimore, duke realizuar komunikim të qartë dhe të mbështetur në ligj dhe Rregullat Etike të prokurorit. Në tre dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet

e vëzhguara, është konstatuar se subjekti identifikon rregullat dhe normat ligjore të zbatueshme, duke dhënë arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të tyre në rastet konkret. Subjekti i rivlerësimit, ka zbatuar e interpretuar drejt bazën ligjore mbi të cilën janë hartuar aktet e ndryshme të tij që i përkasin veprimtarisë së Drejtorisë Gjyqësore, ashtu dhe për tema të ndryshme të punuara prej tij në cilësinë e trajnuesit.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, prokuror Arqilea Koça, ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Aktet procedurale dhe ligjore të hartuara prej tij, në të gjitha dokumentet ligjore të vëzhguara për llogari të subjektit u konstatuan të qarta, logjike dhe të kuptueshme. Përgjithësisht, përmbajtja e akteve është gjithëpërfshirëse dhe u jepet përgjigje në çdo rast problemeve të ngritura në to.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, prokuror Arqilea Koça, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e prokurorit në Drejtorinë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Nga aktet dhe praktikave të analizuar, nuk u konstatuan vonesa apo zvarritje në veprimet e kryera gjatë përfaqësimit të Prokurorisë së Përgjithshme në Gjykatën Kushtetuese, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë apo në Kolegjet Penale të Gjykatës së Lartë, që ka çuar në dhënien e mendimeve respektive sipas afateve kohore të përcaktuara në njoftimet e gjykata ku ka parashtruar mendimet e tij.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Bazuar në analizën e mësipërme të akteve objekt shqyrtimi konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka kryer me kompetencë dhe aftësi, detyrën funksionale të tij, duke ju dhënë rrugë dhe zgjidhje ligjore praktikave të ndryshme në përbërje të Drejtorisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga aktet e analizuar konstatohet se subjekti i rivlerësimit gjatë emtarisë së tij, ka synuar që të paraqesë në mënyrë të shkruar, mangësi të çdo karakteri të konstatuara gjatë gjykimeve në shkallë të ndryshme të gjykimit duke synuar që në rastet e gjykimit në Gjykatën Kushtetuese dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të bëhen përmirësime duke njësuar praktikën gjyqësore.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga studimi i tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura prej tij dhe pesë akteve të përzgjedhura me short, konstatohet se, aktet e subjektit janë të rregullta, të sistemuara sipas kronologjisë kohore. Gjithashtu konstatohet se, pavarësisht llojit të akteve që i përkasin Drejtorisë Gjyqësore, ato janë të plota dhe përfshijnë aktet e komunikimit e nevojshme deri në paraqitjen e mendimit të subjektit si dhe zgjidhjen përfundimtare.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Gjatë periudhës së rivlerësimit ndaj prokurorit nuk ka pasur procedime disiplinore e si rrjedhim as masa disiplinore, si në drejtim të anës profesionale, ashtu dhe atë etike.

Subjekti i rivlerësimit ka pasqyruar një komunikim e bashkëpunim korrekt me kolegët, duke shkëmbyer njohuritë dhe përvojën profesionale me ta, por njëkohësisht edhe sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratës, ka qenë korrekte duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokuror Arqilea Koça, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Referuar vlerësimeve vjetore në periudhën 2014 - 2016, por dhe nga të dhënat në tërësi, subjekti i rivlerësimit konsiderohet si person me integritet të lartë, i paanshmen e objektiv.

c) Paanësia

Nga tre dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Arqilea Koça, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në të tre dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nga të dhënat që i përkasin subjektit të rivlerësimit, z. Arqilea Koça, konstatohet se ka cilësi të mira bashkëpunuese, është i gatshëm të punojë në grup, si dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës profesionale me kolegët e tjerë të të njëjtit nivel, ashtu dhe me prokurorë të shkallëve më të ultë.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Nisur nga vëzhgimi dhe analiza e materialit që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Arqilea Koça, konstatohet angazhimi i vazhdueshëm dhe pjesëmarrja në trajnime të ndryshme të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, subjekti është angazhuar në vazhdimësi, me cilësinë e trajnuesit në programe të ndryshme të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës.

Subjekti i rivlerësimit, z. Arqilea Koça, për tre vitet e fundit në vlerësim të të gjithë elementëve profesionalë, personal, etikë e të disiplinës në punë, është vlerësuar “Shumë Mirë” nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015, 2016.

2. INFORMACIONI I MARRË NË RRUGË ZYRTARE

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit nuk janë paraqitur denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit ligjor të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Pasi janë shqyrtuar pesë dosjet e përzgjedhura me short për subjektin e rivlerësimit, është arritur në të njëjtat konstatime me ato të Grupit të Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

3. RIVLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT SIPAS KRITEREVE TË PARASHIKUARA NË LIGJIN NR. 96/2016 “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në kreun II të tij, parashikon kriteret ligjore për vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorëve. Referuar këtyre kriterëve, në analizë të fakteve dhe rrethanave të përmendura më sipër në këtë vendim, është bërë rivlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Arqile Koca, në përfundim të të cilit ka rezultuar se subjekti është i aftë profesionalisht.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Sipas parashikimit të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendimi i Komisionit në përfundim të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Arqilea Koça, është bazuar (i) në kriterin e pasurisë, (deklarimet periodike, deklarimet për vetting si dhe veprimet dhe mosveprimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë kriter), dhe (ii) vlerësimin tërësor të rrethanave dhe procedurave, bazuar në faktet dhe rrethanat si vijojnë:

- Përfitimi i pasurisë në Korçë, me kontratë privatizimi, datë 05.07.2000, në kundërshtim me ligjin nr. 7652/1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe me qëllim përfitimi, arsyetuar si në këtë vendim.
- Përfitimi i kredisë me statusin e të pastrehut në shumën prej 5.000.000 lekësh, më shumë se një herë, në kundërshtim me ligjin dhe në tejkalim të kriterëve të përcaktuara në VKM-në nr. 102, datë 05.03.1999.
- Mosdeklarim i të ardhurave nga shitja e pasurisë në Korçë, dhe deklarim i rremë, lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”, parashikuar në germa ç, pika 5, neni 33, i ligjit nr. 84/2016.

- Mosdeklarim i ¼ pjesë të pasurisë *** në Delvinë, në deklarin periodik për vitin 2003, dhe atë për vetting, sipas dispozitave të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, dhe nenit D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
- Mosdeklarimi në mënyrë të përsëritur i pasurive në posedim (objekti me sip. 36 m², në ***, Tiranë, në deklarin periodik për vitin 2003 dhe tetë pasuri të paluajtshme, në deklarimet për vitet 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013), ndërkohë që jenë deklaruar rregullisht të ardhura të përfituara nga këto pasuri.
- Nuk u vërtetua bindshëm origjina e pronësisë së sip. 830 m², dhe për rrjedhojë burimi i ligjshëm i krijimit të tetë pasurive të paluajtshme të përfituara nga shoqëria “***” sh.p.k, sipas parashikimit të pikës 3 të nenit D të Kushtetutës.
- Ndërtimi në mënyrë të paligjshme dhe mosdeklarimi i objektit informal, me sip. 36 m² në ***, Tiranë, në deklarin periodik për vitin 2003, sipas dispozitave të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, si dhe veprimet dhe mosveprimet e subjektit në lidhje me këtë objekt, arsyetuar si në këtë vendim.
- Mosdeklarimi i posedimit të tetë pasurive të paluajtshme të përfituara nga shoqëria “***” sh.p.k., në deklarin periodik për vitin 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar.
- Mos vërtetimi i faktit se shtetasit S. Sh. dhe M. G., me cilësinë e huapërdorësave, nuk kanë pasur në pronësi pasuri në qytetin e Tiranës, gjatë periudhës që kanë përdorur pa shpërblim pasuri të paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit, të cilat vënë në pikëpyetje dhënien reale të pasurive në huapërdorje nga ana e subjektit të rivlerësimit.
- Thëniet kontradiktore të subjektit në lidhje me përdorimin e dy prej pasurive, të arsyetuara si në këtë vendim.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues, ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti ka qenë i gatshëm, duke u treguar bashkëpunues, pasi i është përgjigjur brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, ndërkohë që, në ndonjë rast ka dhënë shpjegime justifikuese dhe përgjigje kontradiktore, gjë që është mbajtur në konsideratë në marrjen e vendimit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

IV. SEANCA DËGJIMORE

Më datën 06.03.2019, u zhvillua seanca dëgjimore sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Arqilea Koça, e cila u krye bazuar në të tre kriteret: vlerësimin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioni pasi dëgjoi subjektin, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Arqilea Koça, dhe shpall këtë vendim sot, më datë 08.03.2019, sipas nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLuzion Përfundimtar

Për subjektin e rivlerësimit, z. Arqilea Koça, u konstatua se :

- Ka bërë deklarime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, parashikuar nga neni 61/3 i ligjit nr. 84/2016, dhe si rrjedhim nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Në vlerësim tërësor të rrethanave, me veprimet dhe mosveprimet e tij, subjekti i rivlerësimit, z. Arqilea Koça, ka cënuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, parashikuar nga neni 61/5 i ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, bazuar në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arqilea Koca, me detyrë Prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe

publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 08.03.2019.

ANTËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUES
Etleda ÇIFTJA

ANËTAR/RELATOR
Firdes SHULI

ANËTAR
Roland ILIA

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka